



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 71

**Tiranë – E mërkurë, 23 prill 2025**

## PËRMBAJTJA

|                                                          | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                       |
|----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 17.4.2025 | Për miratimin e Kornizës Kombëtare të Ndërveprimit për Republikën e Shqipërisë..... 7919                                                                                                                                                                   |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 224, datë 17.4.2025 | Për miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Suedisë, lidhur me fazën e tretë të programit për forcimin e policimit në komunitet në Shqipëri..... 7940                                         |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 226, datë 17.4.2025 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar..... 7963                       |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 227, datë 17.4.2025 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 600, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, të ndryshuar..... 7967 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 228, datë 17.4.2025 | Për disa shtesa në vendimin nr. 132, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”..... 7968                                                                      |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 17.4.2025 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 710, datë 12.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit turistik’”..... 7968                                               |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 230, datë 17.4.2025 | Për miratimin e kushteve të negociimit të shoqërisë “KAYO” sh.a., për sigurimin e bashkëpunimit, me qëllim ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e programeve të edukimit dhe trajnimit të pilotëve e të kontrollorëve të fluturimit..... 7969               |

|                                                                                                                |                                                                                                 |      |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të<br>Agjencisë së Zhvillimit të Territorit<br>nr. 102, datë 8.4.2025       | Për delegim kompetence.....                                                                     | 7971 |
| Urdhër i Gjykatës së Shkallës së<br>Parë të Juridiksionit të<br>Përgjithshëm Tiranë nr. 123,<br>datë 15.4.2025 | Për delegimin e kryerjes së detyrave që kanë të bëjnë me procedurat<br>e prokurimit publik..... | 7971 |

**VENDIM****Nr. 216, datë 17.4.2025****PËR MIRATIMIN E KORNIZËS  
KOMBËTARE TË NDËRVEPRIMIT  
PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ë”, të nenit 27, të ligjit nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Kornizës Kombëtare të Ndërveprimit për Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ministritë dhe institucionet e tjera publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

**KORNIZA KOMBËTARE E  
NDËRVEPRIMIT PËR REPUBLIKËN  
E  
SHQIPËRISË****Përmbajtja**

Kreu I: Të përgjithshme

1. Hyrje

1.1 Përkufizimet

1.2 Qëllimi dhe baza ligjore e Kornizës Kombëtare të Ndërveprimit

2. Parimet themelore të shërbimeve publike

2.1 Hyrje

2.2 Parimi themelor 1: Decentralizimi dhe proporcionaliteti

2.3 Parimi themelor 2: Të qenët i hapur (*Openness*)

2.4 Parimi themelor 3: Transparenca

2.5 Parimi themelor 4: Ripërdorimi

2.6 Parimi themelor 5: Neutraliteti teknologjik dhe portabiliteti i të dhënave

2.7 Parimi themelor 6: Fokusim te përdoruesit

2.8 Parimi themelor 7: Përfshirja dhe aksesueshmëria

2.9 Parimi themelor 8: Siguria dhe privatësia

2.10 Parimi themelor 9: Shumëgjuhësia

2.11 Parimi themelor 10: Thjeshtësimi administrativ

2.12 Parimi themelor 11: Ruajtja e informacionit

2.13 Parimi themelor 12: Vlerësimi i efektshmërisë dhe efikasitetit

3. Shtresat e ndërveprimit

3.1 Administrimi i ndërveprimit

3.2 Administrimi i shërbimit publik të integruar

3.3 Ndërveprueshmëria ligjore

3.4 Ndërveprueshmëria organizative

3.5 Ndërveprimi semantik

3.6 Ndërveprimi teknik

4. Modeli konceptual për ofrimin e shërbimeve publike të integruara

4.1 Hyrje

4.2 Përmbledhje e modelit

4.3 Komponentët bazë

5. Përfundim

**Shkurtime**

AKSHI – Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

TIK – Teknologjia e informacionit dhe komunikimit

PKI – Infrastruktura e çelësave publike (*Public Key Infrastructure*)

ROI – Norma e kthimit të investimit (*Return on Investment*)

SOA – Arkitektura e orientuar nga shërbimet (*Service-Oriented Architecture*)

IT – Teknologjia e informacionit (*Information technology*)

BE – Bashkimi Evropian

IPA – Instrumenti për asistencë paraanëtarësimi

MoU – Memorandumet e mirëkuptimit (*Memorandum of Understanding*)

EIF – Korniza Evropiane e Ndërveprimit (*European Interoperability Framework*)

MSA – Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit

**Kreu I: Të përgjithshme**

Ky dokument është pjesë e rëndësishme e standardeve për zhvillimin e fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe shoqërisë së informacionit në vend. Qëllimi i tij është të nxisë dhe të mbështesë shpërndarjen e shërbimeve publike, duke nxitur ndërveprimin ndërmjet sektorëve, të udhëzojë administratën



publike në punën e saj, në mënyrë që të ofrojë shërbime publike në kontekstin kombëtar dhe evropian për biznesin dhe qytetarët.

### 1. Hyrje

Kjo kornizë është rezultat i marrjes në konsideratë të politikave të reja të BE-së, si direktiva e rishikuar për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, direktiva *INSPIRE* “*Directive 2007/2/EC of the European Parliament and of the Council of 14 March 2007*” dhe Rregullorja *eIDAS* “*Regulation (EU) No 910/2014 of the European Parliament and of the Council of 23 July 2014 on electronic identification and trust services for electronic transactions in the internal market and repealing Directive 1999/93/EC*”.

Kjo kornizë jep udhëzime përmes një seti rekomandimesh për institucionet publike se si të përmirësojnë administrimin e proceseve të tyre. Objektivi i kornizës së ndërveprimit është që të kontribuojë në rritjen e efektivitetit të sektorit publik në Shqipëri, duke përmirësuar shërbimet e ofruara ndaj qytetarit dhe biznesit.

Korniza e ndërveprimit është një dokument strategjik që orienton punën e administratës publike në lidhje me teknologjinë e informacionit, të përgatiturit e akteve ligjore lidhur me sistemet elektronike, ndërmarrjen e akteve ligjore për uniformitetin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, me qëllim mirëfunksionimin e ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore. Korniza Kombëtare e Ndërveprimit konceptohet nga Autoriteti Koordinues Rregullues (ARK)/AKSHI, në zbatim të ligjit nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, të ndryshuar, dhe përmbushja e këtij dokumenti është e detyrueshme për të gjithë ata që organizojnë dhe zbatojnë sisteme TIK.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në zbatim të ligjit nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të nenit 14, të vendimit nr. 945, datë 2.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, të ndryshuar”, të vendimit nr. 370, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale ‘Agjenda Digjitale e Shqipërisë’ dhe të planit të veprimit 2022–2026”, ka hartuar Kornizën Kombëtare të Ndërveprimit, në përputhje me Kornizën Evropiane të Ndërveprimit (EIF), e cila është pjesë

e komunikatës së miratuar nga Komisioni Evropian (COM(2017)134).

Procesi i transformimit digjital ka filluar prej kohësh në Shqipëri dhe të gjithë aktorët publikë dhe privatë po punojnë fuqimisht në ndryshimin e mendësisë së qytetarëve dhe të bizneseve në lidhje me këtë formë të re të pashmangshme të komunikimit. Revolucioni digjital i shërbimeve dhe administratës publike në Shqipëri ka ndryshuar perceptimin e qytetarëve në lidhje me komunikimin elektronik me institucionet shtetërore. Sot, rreth 95% të të gjitha shërbimeve publike ofrohen *on-line*. Kjo përkthehet në ulje të kostove të marrjes së shërbimeve, lehtësim të procedurave burokratike, ulje të kohës, por edhe përmirësim të transparencës dhe të cilësisë së ofrimit të tyre.

Qeveria shqiptare, si promovuese e shndërrimit të shërbimeve *off-line* në shërbime *on-line*, ka investuar në ngritjen e sistemeve elektronike, digjitalizimin e arkivave fizike, rritjen e numrit të sistemeve të lidhura në platformën qeveritare të ndërveprimit, shkëmbimin e të dhënave midis tyre, shtimin e shërbimeve elektronike në platformën qeveritare “*e-Albania*”, infrastrukturën fizike, ngritjen e platformave të specifikuara, ku duhet të qarkullojnë dokumentet me vlerë ligjore, nënshkrimin dhe vulë elektronike etj.

Portali unik qeveritar “*e-Albania.al*” shërben si një portë e qendëruar, nëpërmjet së cilës, çdo qytetar apo biznes i interesuar mund të marrë nëpërmjet internetit, shërbime elektronike të ofruara nga institucionet publike në Shqipëri. Portali qeveritar “*e-Albania*” është e ndërlidhur me platformën qeveritare të ndërveprimit, e cila është arkitektura bazë për të cilën mundësohet ndërveprimi me regjistrat elektronikë të institucioneve publike, si një hap i domosdoshëm për thjeshtimin e shërbimeve që shteti shqiptar ofron për qytetarët, bizneset dhe administratën publike, duke reduktuar numrin e dokumenteve që i kërkohen qytetarit apo biznesit për marrjen e shërbimeve publike. Platforma e ndërveprimit lidhet përmes rrjetit qeveritar *GovNet* me sistemet elektronike të administratës publike.

Rrjeti *GovNet* është një rrjet privat qeveritar në fibër optike. Nëpërmjet infrastrukturës “*core network*” dhe “*distribution network*”, e ndërtuar nga pajisje të një teknologjie të fundit dhe me një siguri të avancuar, ky rrjet ka arritur të jetë prezent në mbi 250 institucione qeveritare, duke shpërndarë internet dhe shërbime të tjera të përqendruara.



Qendra e të dhënave qeveritare shërben si një pikë kryesore e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit të institucioneve të administratës publike. Kjo qendër është ngritur sipas standardeve bashkëkohore të kushteve për serverët dhe mundëson që të gjithë shërbimet *on-line* qeveritare të jenë të qendëruara e të integruara. Ajo ka një sipërfaqe prej 672 m<sup>2</sup> dhe përfshin 11 ambiente për infrastrukturën teknike, monitorimin dhe sigurimin e shërbimeve elektronike. Qendra e të dhënave qeveritare i ofron çdo ministrie/agjencie optimizimin e kostove, pasi nëpërmjet saj kanë mundësinë të përdorin një infrastrukturë të standardeve më të mira, duke evituar shpenzimet e panevojshme dhe të tepërta, që do të duheshin për të krijuar infrastruktura të veçanta.

### 1.1 Përkufizimet

#### 1.1.1 Ndërveprimi

Për qëllimet e kornizës, ndërveprimi është aftësia për të integruar ndarjen e informacionit dhe njohurive midis palëve, institucioneve, përmes proceseve të punës që ato mbështesin, nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave ndërmjet sistemeve të tyre të TIK-ut.

Ndërveprimi adreson nevojën, për:

- bashkëpunim ndërmjet sektorëve të administratës publike në ofrimin e shërbimeve publike;
- shkëmbim të informacionit ndërmjet sektorëve të administratës publike për të përmbushur kërkesat ligjore ose angazhimet politike;
- ndarjen dhe ripërdorimin e informacionit midis sektorëve të administratës publike për të rritur efikasitetin administrativ.

Rezultati është:

- ofrimi i përmirësuar i shërbimeve publike për qytetarët dhe bizneset;
- kosto më të ulëta për administratat publike, bizneset dhe qytetarët për shkak të ofrimit efikas të shërbimeve publike;
- më pak burokraci dhe më shumë lehtësi në marrjen e shërbimeve publike.

Shërbimi publik elektronik

*“Shërbimi publik elektronik” është shërbimi, i cili ofrohet nga autoritetet publike për personat fizikë dhe juridikë të interesuar ose ndërmjet vetë autoriteteve publike përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në tipologjinë*

*administratë – administratë, administratë – qytetar, administratë – biznes.*

### Struktura e ndërveprimit

Struktura e ndërveprimit është një qasje e përbashkët, e pranuar për ofrimin e shërbimeve publike të ndërveprueshme. Ajo përcakton udhëzimet themelore të ndërveprimit në formën e parimeve, modeleve dhe rekomandimeve të përbashkëta.

### 1.2 Qëllimi dhe baza ligjore e Kornizës Kombëtare të Ndërveprimit

Qëllimi i Kornizës Kombëtare të Ndërveprimit është:

- të frymëzuarit e institucioneve publike në përpjekjet e tyre për të implementuar dhe për të ofruar shërbime publike pa pengesa për institucionet e tjera publike, qytetarët dhe bizneset që janë, sa të jetë e mundur, digjitale-si-parazgjedhje (d.m.th. ofrimi i shërbimeve dhe të dhënave përmes kanaleve digjitale, “*digital-by-default*”), ndërkufitare-si-parazgjedhje (d.m.th. të aksesueshme për të gjithë qytetarët në BE) dhe të hapura-si-parazgjedhje (d.m.th. mundësimi i ripërdorimit, pjesëmarrjes/ aksesit dhe transparencës);
- të ofruarit e udhëzimeve për institucionet publike mbi projektimin dhe përditësimin e politikave, strategjive dhe udhëzimeve kombëtare që promovojnë ndërveprimin;
- të kontribuarit në themelimin e tregut të vetëm digjital, duke nxitur ndërveprimin ndërkufitar dhe ndërsektorial për ofrimin e shërbimeve publike ndërkufitare.

Mungesa e ndërveprimit është një pengesë kryesore për përparimin në tregun e vetëm digjital në aspektin evropian. Përdorimi i EIF-së dhe kornizave kombëtare për të drejtuar iniciativat evropiane të ndërveprimit kontribuon në një mjedis evropian të ndërveprueshëm dhe koherent dhe lehtëson ofrimin e shërbimeve që punojnë së bashku, brenda dhe ndërmjet organizatave ose fushave. EIF-ja promovohet dhe mirëmbahet kryesisht nga programi ISA<sup>1</sup>, në bashkëpunim të ngushtë midis shteteve anëtare dhe Komisionit Evropian në frymën e neneve 26, 170 dhe 171 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, që bën thirrje për themelimin e rrjeteve ndërevropiane të ndërveprueshme, që do të

<sup>1</sup> Established by Decision (EU) 2015/2240 of the European Parliament and of the Council of 25 November 2015


mundësojnë qytetarët të përfitojnë plotësisht nga një treg i brendshëm evropian. EIF-ja përcakton kushtet bazë për arritjen e ndërveprimit, duke vepruar si emëruesi i përbashkët për iniciativat përkatëse në të gjitha nivelet, përfshirë ato evropiane, kombëtare, rajonale dhe lokale, duke përfshirë administratat publike, qytetarët dhe bizneset.

Në një mënyrë të ngjashme, kuadrot e specifika të ndërveprueshmërisë (DIF) duhet të mbeten të përputhshme me fushën e veprimit të EIF-së dhe, ku është e nevojshme, të zgjerojnë këtë fushë për të kapur kërkesat specifike të ndërveprimit të fushës në fjalë. Kjo do të thotë se disa nga elementet e EIF-së

mund aplikohen direkt në një kornizë kombëtare të ndërveprimit (NIF) ose DIF, ndërsa të tjerët mund të kenë nevojë të kontekstualizohen dhe të përshtaten më tej për të mbuluar nevojat e veçanta.

Marrëdhënia midis EIF-së, NIF-së dhe DIF-së është përshkruar në figurën 1. EIF-ja ofron një bërthamë të përbashkët të elementeve të ndërveprimit për NIF-në dhe DIF-në evropiane. Përputhshmëria me EIF-në garanton se NIF-ja dhe DIF-ja<sup>2</sup> zhvillohen në një mënyrë të koordinuar dhe të përputhshme, ndërsa ofrojnë fleksibilitetin e nevojshëm për të trajtuar kërkesat specifike që vijnë nga kërkesat kombëtare ose specifike të fushës.

Figura 1. Marrëdhënia midis EIF-së, NIF-së dhe DIF-së



<sup>2</sup> Për shembull, direktiva 2007/2/EC që themelon një infrastrukturë për informacionin hapësinor në Komunitetin Faqe | 7922

Evropian (INSPIRE), dhe rregullat dhe udhëzimet përkatëse për zbatimin e saj.



Në përgjithësi, EIF-ja ofron vlerë në dy drejtime:

- *nga poshtë-lart*: kur një kornizë kombëtare e përshtatur me EIF-në përdoret për zbatimin e shërbimeve publike në të gjitha nivelet e administratave kombëtare, krijon kushtet e ndërveprimit për zgjerimin e fushës së këtyre shërbimeve përtej kufijve;

- *nga lart-poshtë*: kur EIF-ja merret parasysh në legjislacionin dhe fushat e politikave të BE-së, përmes referencave *ad hoc* ose më strukturalisht duke përdorur DIFs, rrit potencialin e ndërveprimit të veprimeve kombëtare vijuese, që rezultojnë nga transpozimi.

Në të dyja rastet, rezultati i fundit është zhvillimi i një ekosistemi evropian të shërbimeve publike, në të cilin zotëruarit dhe projektuesit e sistemeve dhe shërbimeve publike bëhen të vetëdijshëm për kërkesat e ndërveprimit, administratat publike janë të gatshme të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me biznese e qytetarë dhe informacioni rrjedh pa probleme përtej kufijve për të mbështetur një treg të vetëm digjital në Evropë.

### 1.2.1 Fushat e ndërveprimit

Fusha e kornizës mbulon tri lloje të ndërveprimeve:

- A2A (administratë për administratë), që i referohet ndërveprimeve midis administratave publike (p.sh. shteti anëtar ose institucionet e BE-së);

- A2B (administratë për biznes), që i referohet ndërveprimeve midis administratave publike (në një shtet anëtar ose një institucion të BE-së) dhe bizneseve;

- A2C (administratë për qytetar), që i referohet ndërveprimeve midis administratave publike (në një shtet anëtar ose një institucion të BE-së) dhe qytetarëve.

(NIF) Korniza Kombëtare e Ndërveprimit enti 1

(NIF) Korniza Kombëtare e Ndërveprimit enti 2

(DIFs) Kornizat e Ndërveprimit së Fushave

(EIF) Korniza Evropiane e Ndërveprimit

Mungesa e ndërveprimit është një pengesë kryesore për përparimin e tregut të vetëm digjital.

### 1.2.2 Përmbajtja dhe struktura

Përmbajtja dhe struktura e kësaj kornize është, si më poshtë vijon:

- Kreu 2 prezanton një set të parimeve të përcaktuara për të vendosur praktika të përgjithshme mbi ndërveprimin.

- Kreu 3 prezanton një model ndërveprimi të shtresëzuar që organizon në shtresa aspektet e ndryshme të ndërveprimit që duhet të trajtohen kur projektohen shërbimet publike.

- Kreu 4 paraqet një model konceptual për shërbimet publike ndërvepruese. Ai është i përshtatur me parimet e ndërveprimit dhe promovon idenë e “ndërveprimit-që-në-projektim”, si një qasje standarde për projektimin dhe operimin e shërbimeve publike.

- Kreu 5 ofron një pasqyrë dhe duke lidhur së bashku elementet kryesore të kornizës.

- Në krerë të ndryshëm trajtohet një set me rekomandime, si veprime të zbatueshme për t'u zbatuar nga institucionet publike.

## 2. Parimet themelore të shërbimeve publike

### 2.1 Hyrje

Parimet e ndërveprimit janë aspekte të sjelljes themelore për të drejtuar veprimet e ndërveprueshmërisë. Ky kapitull përcakton parimet e përgjithshme të ndërveprimit që janë të rëndësishme për procesin e krijimit të shërbimeve publike të ndërveprueshme. Ato përshkruajnë kontekstin në të cilin shërbimet publike projektohen dhe zbatohen.

Dymbëdhjetë parimet themelore të Kornizës Evropiane të Ndërveprimit (EIF) janë të grupuara në katër kategori:

I. Parimi që përcakton kontekstin për veprimet e BE-së në fushën e ndërveprueshmërisë (nr. 1);

II. Parimet kryesore të ndërveprimit (nr. 2 deri në 5);

III. Parime që lidhen me nevojat dhe pritshmëritë e përgjithshme të përdoruesve (nr. 6 deri në 9);

IV. Parimet themelore për bashkëpunimin ndërmjet administratave publike (nr. 10 deri në 12).

1. Subsidiariteti dhe proporcionaliteti

– 1 rekomandim

2. Hapja

– 3 rekomandime

3. Transparenca

– 1 rekomandim

4. Ripërdorueshmëria

– 2 rekomandime

5. Neutraliteti teknologjik dhe transportueshmëria e të dhënave

– 2 rekomandime

6. Përqendrimi te përdoruesi

– 4 rekomandime



7. Përfshirja dhe aksesueshmëria  
– 1 rekomandim
8. Siguria dhe privatësia  
– 1 rekomandim
9. Shumëgjuhësia  
– 1 rekomandim
10. Thjeshtimi administrativ  
– 1 rekomandim
11. Ruajtja e informacionit  
– 1 rekomandim
12. Vlerësimi i efektivitetit dhe efikasitetit  
– 1 rekomandim

## 2.2 Parimi themelor 1: Decentralizimi dhe proporcionaliteti

Parimi i parë themelor bën thirrje për decentralizim dhe proporcionalitet që është mishëruar në traktatin e BE-së. Parimi i decentralizimit kërkon që vendimet të merren sa më pranë qytetarit. Me fjalë të tjera, ky parim vendos thelbin e autonomisë së ndërveprimit. Parimi i proporcionalitetit kufizon veprimin e administratës qendrore, në atë që është e nevojshme për të arritur politikën dhe për t'u pajtuar me objektivat.

### Rekomandimi 1:

*Të sigurohet që kornizat kombëtare të ndërveprimit dhe strategjitë e ndërveprimit janë të përshtatura me EIF dhe, nëse është e nevojshme, të përshtaten dhe zgjerohen për të adresuar kontekstin dhe nevojat kombëtare.*

## 2.3 Parimi themelor 2: Të qenët i hapur (Openness)

Në kontekstin e shërbimeve publike të ndërsjellshme, koncepti i të qenit i hapur lidhet kryesisht me të dhënat, specifikimet dhe *software*.

Të dhënat e qeverisjes së hapur (këtu thjesht i referohet si “të dhëna të hapura”) i referohet idesë se të gjitha të dhënat publike duhet të jenë të lira për përdorim dhe ripërdorim nga të tjerët, përveç në rastet kur aplikohen kufizime, p.sh. për mbrojtjen e të dhënave personale, konfidencialitetin, ose të drejtat e pronësisë intelektuale. Institucionet publike mbledhin dhe gjenerojnë sasi të mëdha të dhënash. Direktiva për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik (PSI)<sup>3</sup> inkurajon shtetet anëtare në nivel BE-je të bëjnë të dhënat publike të disponueshme për qasje dhe ripërdorim si të dhëna të hapura. Direktiva *INSPIRE* kërkon, përveç tjerash, ndarjen e seteve të dhënash hapësinore dhe

shërbimeve midis autoriteteve publike pa kufizime ose pengesa praktike për ripërdorimin e saj. Këto të dhëna duhet të publikohen me sa më pak kufizime të mundshme dhe me licenca të qarta për përdorimin e tyre për të lejuar një kontroll më të mirë të proceseve të vendimarrjes së administratave dhe për të realizuar transparencën në praktikë.

Të dhënat e hapura trajtohen më në detaje në seksionin 4.3.4.

### Rekomandimi 2:

*Të publikohen të dhënat që zotërohen si të dhëna të hapura, përveç në rastet kur aplikohen kufizime të caktuara.*

Përdorimi i teknologjive dhe produkteve *software* me burim të hapur mund të ndihmojë në kursimin e kostos së zhvillimit në raste të caktuara, duke lejuar përshtatjen e shpejtë me nevojat specifike të projektit sepse komunitetet e zhvilluesve kanë mundësi të ndihmojnë me përmirësime dhe përshtatje të vazhdueshme. Administrata, për sa të jetë e mundur, mundet të përdorë zgjidhjet me burim të hapur, por sa herë që është e mundur, edhe të kontribuojnë në komunitetet e zhvilluesve përkatës.

### Rekomandimi 3:

*Të sigurohet një terren i barabartë për software me burim të hapur dhe të dëshmohet një vlerësim aktiv dhe i paanshëm për përdorimin e tyre, duke marrë parasysh koston totale të zotërimit të zgjidhjes.*

Përdorimi i specifikimeve të hapura është vendimtar për ripërdorimin e përbërësve *software* që zbatojnë atë specifikim. Kjo vlen gjithashtu edhe kur këta përbërës përdoren për të prezantuar shërbime të reja publike evropiane. Nëse parimi i hapjes zbatohet plotësisht:

- të gjithë aktorët e interesuar kanë mundësinë të kontribuojnë në zhvillimin e specifikimit dhe rishikimi publik është pjesë e procesit vendim-marrës;

- specifikimi është i disponueshëm për këdo që dëshiron ta studiojë;

- të drejtat e pronësisë intelektuale për specifikimin licencohen sipas kushteve FRAND (të ndershme, të arsyeshme dhe të mosdiskriminuese), në një mënyrë që lejon zbatimin si në *software* të pronësuar, ashtu edhe në *software* me burim të hapur, dhe në mënyrë të preferueshme pa tarifa (*royalty-free*).

<sup>3</sup> Drejtuesi 2003/98/EC dhe siç është rishikuar nga drejtuesi 2013/37/EU.





Për shkak të efektit të tyre pozitiv në ndërveprim, përdorimi i specifikimeve të hapura është promovuar në shumë deklarata politike dhe është i inkurajuar për ofrimin e shërbimeve publike. Efekti pozitiv i specifikimeve të hapura është demonstruar gjerësisht. Megjithatë, administratat publike mund të vendosin të përdorin specifikime më pak të hapura nëse ato të hapura nuk ekzistojnë ose nuk plotësojnë nevojat funksionale. Në të gjitha rastet, specifikimet duhet të jenë të maturuara dhe të mbështetura mjaftueshëm nga tregu, përveç nëse përdoren për të krijuar zgjidhje inovative.

#### *Rekomandimi 4:*

*T'i jepet përparësi specifikimeve të hapura, duke marrë parasysh në mënyrë të duhur mbulimin e nevojave funksionale, maturitetin dhe mbështetjen e tregut dhe inovacionin.*

Së fundi, të qenët i hapur do të thotë fuqizim i qytetarëve dhe bizneseve për të marrë pjesë në projektimin e shërbimeve të reja, për të kontribuar në përmirësimin e shërbimit dhe për të dhënë reagime rreth cilësisë së shërbimeve publike ekzistuese.

#### **2.4 Parimi themelor 3: Transparenca**

Qytetarët dhe bizneset duhet të jenë në gjendje të kuptojnë proceset administrative. Ata duhet të kenë të drejta për të ndjekur procedurat administrative që përfshijnë ato dhe të kenë njohuri për logjikën e vendimeve që mund të ndikojnë tek ata.

Transparenca në kontekstin e kornizës i referohet:

1. mundësimin të transparencës dhe shikueshmërisë brenda mjedisit administrativ të një institucioni publik. Kjo vlen për të lejuar institucionet e tjera publike, qytetarët dhe bizneset të shohin dhe të kuptojnë rregullat administrative, proceset, të dhënat, shërbimet dhe vendimmarrjen;

2. sigurimit të disponueshmërisë së ndërfaqeve me sistemet e brendshme të informacionit. Institucionet publike operojnë një numër të madh të atyre që shpesh janë sisteme të informacionit të ndryshme dhe të ndarë në mbështetje të proceseve të tyre të brendshme. Ndërveprimi varet nga siguri i disponueshmërisë së ndërfaqeve për këto sisteme dhe të dhënat që ato trajtojnë. Në këmbim, ndërveprimi lehtëson ripërdorimin e sistemeve dhe të dhënave dhe mundëson që këto të integrohen në sisteme më të mëdha;

3. sigurimit të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar kuadrin ligjor të aplikueshëm për sasi të mëdha të të dhënave personale të qytetarëve, të mbajtura dhe të menaxhuara nga administratat publike.

#### *Rekomandimi 5:*

*Të sigurohet transparencë dhe të ofrohen ndërfaqe të jashtme me informacion për shërbimet publike.*

#### **2.5 Parimi themelor 4: Ripërdorimi**

Ripërdorimi do të thotë që administratat publike, që përballen me një problem specifik, të mund të shfrytëzojnë punën e të tjerëve duke parë se çfarë është në dispozicion, duke vlerësuar dobishmërinë ose rëndësinë e saj për problemin në fjalë, dhe ku është e përshtatshme, duke adoptuar zgjidhje që kanë provuar vlerën e tyre diku tjetër. Kjo kërkon që administrata publike të jetë e hapur të ndajë zgjidhjet e saj të ndërveprimit, koncepteve, kornizave, specifikimeve, mjeteve dhe komponentëve me të tjerët.

Ripërdorimi i zgjidhjeve të IT-së (p.sh. komponentët *software*, ndërfaqet e programimit të aplikacioneve, standardet), informacioni dhe të dhënat, është një mundësues i ndërveprimit dhe përmirëson cilësinë sepse zgjeron përdorimin operacional, si dhe kursen paratë dhe kohën. Kjo e bën atë një kontribuues të madh edhe në zhvillimin e një tregu të vetëm digjital në BE. Disa standarde dhe specifikime të BE-së ekzistojnë gjithashtu në DIF-të dhe duhet të aplikohen më gjerësisht. Për shembull, direktiva *INSPIRE* përcakton standarde ndërveprimi për adresat, kadastrat, rrugët dhe shumë tema të tjera të të dhënave të rëndësishme për shumë administrata publike. Këto standarde dhe specifikime ekzistuese mund dhe duhet të përdoren më gjerësisht jashtë fushës për të cilën ato u zhvilluan fillimisht.

Ka disa sfida kyçe, që kufizojnë ndarjen dhe ripërdorimin e zgjidhjeve të IT-së në nivele teknike, organizative, ligjore dhe të komunikimit. Korniza e ISA<sup>2</sup> për ndarjen dhe ripërdorimin e zgjidhjeve të IT-së ofron rekomandime për administratat publike për t'i ndihmuar ato të përballen me këto sfida dhe të ndajnë/rindjekin zgjidhje të përbashkëta të IT-së. Ripërdorimi dhe ndarja mund të mbështeten efektivisht nga platformat bashkëpunuese.<sup>4</sup>

#### *Rekomandimi 6:*

*software* me burim të hapur, asetet semantike, bloqet ndërtuese dhe praktikant më të mira. Komisioni Evropian ka

<sup>4</sup> Në nivelin e BE-së, është krijuar platforma *Joinup* (<https://joinup.ec.europa.eu/>) për të ndarë komponentët e



*Të ripërdoren dhe ndaben zgjidhjet e të bashkëpunohet në zhvillimin e zgjidhjeve të përbashkëta kur implementohen shërbimet publike.*

*Rekomandimi 7:*

*Të ripërdoret dhe ndahet informacioni dhe të dhënat kur implementohen shërbimet publike, përveç nëse aplikohen kufizime të caktuara të privatësisë ose konfidencialitetit.*

## **2.6 Parimi themelor 5: Neutraliteti teknologjik dhe portabiliteti i të dhënave**

Gjatë implementimit të shërbimeve publike, administratat publike duhet të përqendrohen në nevojat funksionale dhe të shtyjnë marrjen e vendimeve për teknologjinë sa më gjatë që të jetë e mundur, me qëllim që të minimizojnë varësinë teknologjike, të shmangin imponimin e zbatimeve teknike apo produkteve specifike ndaj përdoruesve të tyre, si dhe të mundësojnë përshtatjen ndaj një mjedisi teknologjik në zhvillim të vazhdueshëm.

Administratat publike duhet të sigurojnë aksesin dhe ripërdorimin e shërbimeve dhe të dhënave publike, pavarësisht nga teknologjitë apo produktet specifike.

*Rekomandimi 8:*

*Të mos imponohen zgjidhje teknologjike për qytetarët, bizneset dhe administratat e tjera, që lidhen me një teknologji të caktuar ose jo, në përputhje me nevojat e tyre reale.*

Funksionimi i tregut të vetëm digjital kërkon që të dhënat të jenë të transferueshme lehtësisht midis sistemeve të ndryshme për të shmangur bllokimin, duke mbështetur lëvizjen e lirë të të dhënave.

Kjo kërkesë lidhet me portabilitetin e të dhënave – aftësinë për të lëvizur dhe ripërdorur të dhënat lehtësisht midis aplikacioneve dhe sistemeve të ndryshme, e cila bëhet edhe më sfiduese në skenarë ndërkuftarë.

*Rekomandimi 9:*

*Të sigurohet portabiliteti i të dhënave, pra që të dhënat të jenë të transferueshme lehtësisht midis sistemeve dhe aplikacioneve, që mbështesin implementimin dhe evolucionin e shërbimeve publike, pa kufizime të paarsyeshme, nëse është e mundur ligjërish.*

## **2.7 Parimi themelor 6: Fokusim te përdoruesit**

Shërbimet publike kanë për qëllim t'u shërbejnë nevojave të administratës, qytetarëve dhe bizneseve. Përdoruesit e shërbimeve publike duhet të jenë çdo administratë publike, qytetarë ose biznese që

aksesojnë dhe përfitojnë nga përdorimi i këtyre shërbimeve.

Kur përcaktohet se cilat shërbime publike duhet të ofrohen dhe si duhet të ofrohen ato, duhet të merren parasysh nevojat e përdoruesve.

Pra, sa më shumë që të jetë e mundur, nevojat dhe kërkesat e përdoruesve duhet të udhëzojnë projektimin dhe zhvillimin e shërbimeve publike, në përputhje me pritshmëritë e mëposhtme:

- Qasja në kanale të ndryshme elektronike për të aksesuar një shërbim, është një pjesë e rëndësishme e projektimit të shërbimit publik, pasi përdoruesit mund të preferojnë kanale të ndryshme në varësi të rrethanave dhe nevojave të tyre;

- Duhet të jetë e disponueshme për përdoruesit një pikë e vetme kontakti (*zbatimi i konceptit one-stop-shop në platformën qeveritare e-albania.al*), për të fshehur kompleksitetin administrativ të brendshëm dhe për të lehtësuar qasjen në shërbimet publike, p.sh. kur disa organe duhet të punojnë së bashku për të ofruar një shërbim publik;

- Duhet të mblidhen reagimet e përdoruesve, të vlerësohen dhe përdoren sistematikisht për të projektuar shërbime të reja publike dhe për të përmirësuar më tej ato ekzistuese;

- Sa më shumë që është e mundur, sipas legjislacionit në fuqi, përdoruesit duhet të jenë në gjendje të japin të dhëna vetëm një herë, dhe administratat duhet të jenë në gjendje të marrin dhe ndajnë këto të dhëna për të shërbyer përdoruesit, në përputhje me rregullat e mbrojtjes së të dhënave;

- Përdoruesit duhet të kërkojnë të japin vetëm informacionin që është absolutisht i nevojshëm për të marrë një shërbim publik të caktuar.

*Rekomandimi 10:*

*Përdorimi i kanaleve të ndryshme dhe elektronike për ofrimin e shërbimeve publike, në mënyrë që përdoruesit të kenë mundësinë të zgjedhin kanalën që i përshtatet më së miri nevojave të tyre.*

*Rekomandimi 11:*

*Ofrimi i një pikë të vetme kontakti për të fshehur kompleksitetin administrativ të brendshëm dhe për të lehtësuar qasjen e përdoruesve në shërbimet publike evropiane.*

*Rekomandimi 12:*

*Vendosja e mekanizmave për të përfshirë përdoruesit në analizë, projektim, vlerësim dhe zhvillim të mëtejshëm të shërbimeve publike.*

*Rekomandimi 13:*

*Sa më shumë që është e mundur sipas legjislacionit në fuqi, t'u kërket përdoruesve të shërbimeve publike informacion vetëm një herë dhe vetëm atë që është i rëndësishëm.*

**2.8 Parimi themelor 7: Përfshirja dhe aksesueshmëria**

Përdorimi i TIK-ut duhet të krijojë mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët dhe bizneset nëpërmjet përfshirjes së shërbimeve që janë publikisht të arritshme pa asnjë lloj diskriminimi.

Përfshirja do të thotë t'u mundësosh të gjithë përdoruesve të përfitojnë plotësisht nga mundësitë që ofrojnë teknologjitë e reja për të aksesuar dhe për të përdorur shërbimet publike, duke kapërcyer ndarjet sociale e ekonomike dhe përjashtimin.

Aksesueshmëria siguron që personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe grupet e tjera të përjashtuara të mund të përdorin shërbimet publike në nivele shërbimi, të krahasueshme me ato që ofrohen për qytetarët e tjerë.<sup>5</sup>

Përfshirja dhe aksesueshmëria duhet të jenë pjesë e ciklit të tërë të zhvillimit të një shërbimi publik në aspektin e projektimit, përmbytjes së informacionit dhe dorëzimit. Ajo duhet të përmbushë specifikimet e aksesueshmërisë *on-line*, të njohura gjerësisht në nivel evropian ose ndërkombëtar.

Përfshirja dhe aksesueshmëria zakonisht kërkojnë ofrim të shërbimeve përmes kanaleve të shumfishta. Ofrimi tradicional i shërbimeve përmes dokumenteve në letër ose kontakteve ballë për ballë mund të ketë nevojë të bashkekzistojë me ofrimin elektronik të tyre.

Përfshirja dhe aksesueshmëria gjithashtu mund të përmirësohen nga aftësia e një sistemi informacioni për të lejuar palët e treta të veprojnë në emër të qytetarëve që janë të paafte, përgjithmonë ose përkohësisht, të përdorin direkt shërbimet publike.

*Rekomandimi 14:*

*Të sigurohet që të gjitha shërbimet publike të jenë të aksesueshme për të gjithë qytetarët, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe grupet e tjera të përjashtuara. Për shërbimet publike digjitale, administratat publike duhet të përmbushin specifikimet e aksesueshmërisë *on-line*, që janë të njohura gjerësisht në nivel evropian ose ndërkombëtar.*

**2.9 Parimi themelor 8: Siguria dhe privatësia**

Qytetarët dhe bizneset duhet të jenë të sigurt se ndërveprojnë me autoritetet publike në një mjedis të sigurt e të besueshëm dhe në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës.

Kjo do të thotë që administrata publike duhet të garantojë privatësinë e qytetarëve dhe konfidencialitetin, autenticitetin, integritetin dhe moshedhjen poshtë të informacionit të ofruar nga qytetarët dhe bizneset. Siguria dhe privatësia trajtohen më hollësisht në seksionin 4.3.7.

*Rekomandimi 15:*

*Të përcaktohet një kuadër i përbashkët i sigurisë dhe privatësisë dhe të vendosen procese për shërbimet publike për të siguruar shkëmbimin e të dhënave të sigurta dhe të besueshme midis administratave publike dhe në ndërveprimet me qytetarët dhe bizneset.*

**2.10 Parimi themelor 9: Shumëgjuhësia**

Shërbimet publike mund të përdoren potencialisht nga kushdo. Prandaj, shumëgjuhësia duhet të merret parasysh me kujdes kur ato projektohen. Shtetasit e huaj shpesh kanë probleme në aksesimin dhe përdorimin e shërbimeve publike digjitale nëse ato nuk janë të disponueshme në gjuhët që ata flasin.

Duhet të gjendet një ekuilibër midis pritshmërive të qytetarëve dhe bizneseve për të qenë të shërbyer në gjuhën (gjuhët) e tyre ose gjuhën (gjuhët) e tyre të preferuar dhe aftësisë së administratave publike për të ofruar shërbime në të disa gjuhë ndërkombëtare. Një ekuilibër i përshtatshëm që mund të aplikohet lidhet me faktin që shërbimet publike të jenë të disponueshme në gjuhët e përdoruesve të pritur, pra numri i gjuhëve vendoset në bazë të nevojave të përdoruesve.

Shumëgjuhësia vlen jo vetëm në ndërfaqen e përdoruesit, por në të gjitha nivelet e projektimit të shërbimeve publike. Aspekti i prezantimit shumëgjuhësh në kuadrin e ndërveprimit bëhet përsëri i dukshëm kur shërbimet publike kërkojnë shkëmbim midis sistemeve të TIK-ut përmes kufijve gjuhësorë. Informacioni që shkëmbehet duhet të ruhet dhe të jetë asnjans në aspektin gjuhësor.

<sup>5</sup> Direktiva BE 2016/2102 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit të 26 tetorit 2016 për aksesueshmërinë e faqeve të internetit dhe aplikacioneve mobile të institucioneve publike

dhe puna e nisur nga Komisioni për një "Akt evropian për aksesueshmëri".



#### Rekomandimi 16:

*Të përdoren sistemet e informacionit dhe arkitekturat teknike që përshtaten me shumëgjubësinë kur krijohet një shërbim publik. Të vendoset niveli i mbështetjes së shumëgjubësisë, bazuar në nevojat e përdoruesve të pritshëm.*

#### 2.11 Parimi themelor 10: Thjeshtësimi administrativ

Sa të jetë e mundur, administratat publike duhet të përpigjen të racionalizojnë dhe të thjeshtojnë proceset e tyre administrative, duke i përmirësuar ato ose duke eliminuar çdo proces që nuk ofron vlerë publike. Thjeshtësimi administrativ mund të ndihmojë bizneset dhe qytetarët të reduktojnë barrën administrative të përmbushjes së legjislacionit në fuqi. Po ashtu, institucionet publike duhet të prezantojnë shërbime publike të mbështetura nga mjetet elektronike, përfshirë ndërveprimet e tyre me institucione të tjera publike, qytetarë dhe biznese.

Në përcaktimet e ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, ndalohet krijimi i bazave të të dhënave shtetërore të veçanta për të njëjtin informacion ose qëllim.

Digjitalizimi i shërbimeve publike duhet të ndodhë në përputhje me konceptet e mëposhtme:

- *Digjitale-si-parazgjedhje*, kur është e përshtatshme, në mënyrë që të ketë të paktën një kanal digjital në dispozicion për të hyrë dhe përdorur një shërbim publik të caktuar;

- *Digjitale-si-prioritet*, që do të thotë se përparësi i jepet përdorimit të shërbimeve publike elektronike përmes kanaleve digjitale, duke zbatuar konceptin e ofrimit përmes kanaleve të shumta dhe parimin “*pa derë të gabuar*”, pra bashkekzistencën e kanaleve fizike dhe digjitale.

#### Rekomandimi 17:

*Të thjeshtohen proceset dhe të përdoren kanale digjitale kur është e përshtatshme për dorëzimin e shërbimeve publike, për t’u përgjigjur në kohë dhe me cilësi të lartë kërkesave të përdoruesve dhe për të reduktuar barrën administrative mbi administratat publike, bizneset dhe qytetarët.*

#### 2.12 Parimi themelor 11: Ruajtja e informacionit

Legjislacioni kërkon që vendimet dhe të dhënat të ruhen dhe të mund të aksesohen për një kohë të caktuar. Kjo do të thotë se regjistrat dhe informacioni në formë elektronike të mbajtur nga administrata publike për qëllim të dokumentimit të

procedurave dhe vendimeve duhet të ruhen dhe të konvertohen, nëse është e nevojshme, në mjete të reja komunikimi kur ato të vjetra bëhen të papërdorshme. Qëllimi është të sigurohet se regjistrat dhe format e tjera të informacionit ruajnë lexueshmërinë, besueshmërinë dhe integritetin dhe mund të aksesohen sa të jetë e nevojshme, në përputhje me dispozitat e sigurisë dhe privatësisë.

Për të garantuar ruajtjen afatgjatë të të dhënave elektronike dhe llojeve të tjera të informacionit, duhet të zgjidhen formatet për të siguruar aksesin afatgjatë, duke përfshirë ruajtjen e nënshkrimeve apo vulave elektronike.

#### Rekomandimi 18:

*Të formulohet një politikë afatgjatë ruajtjeje për informacionin që lidhet me shërbimet publike dhe veçanërisht për informacionin që shkëmbehet përtej kufijve.*

#### 2.13 Parimi themelor 12: Vlerësimi i efektshmërisë dhe i efikasitetit

Ka shumë mënyra për të vlerësuar vlerën e shërbimeve publike të ndërveprueshme, duke përfshirë konsiderata, si: kthimi i investimit, kosto totale e pronësisë, niveli i fleksibilitetit dhe adaptueshmërisë, ulja e barrës administrative, efikasiteti, ulja e rrezikut, transparenca, thjeshtësimi, përmirësimi i metodave të punës, dhe niveli i kënaqësisë së përdoruesit.

Duhet të vlerësohen zgjidhje teknologjike të ndryshme kur synohet të sigurohet efektshmëria dhe efikasiteti i një shërbimi publik.

#### Rekomandimi 19:

*Të vlerësohet efektshmëria dhe efikasiteti i zgjidhjeve të ndryshme të ndërveprimit dhe opsioneve teknologjike, duke marrë parasysh nevojat e përdoruesit, proporcionin dhe balancën kosto-përfitim.*

#### 3. Shtresat e ndërveprimit

Ky kapitull përshkruan një model ndërveprimi, i cili është i zbatueshëm për të gjitha shërbimet publike digjitale dhe gjithashtu mund të konsiderohet si një element integral i “ndërveprimit që-në-projektim”. Ai përfshin:


- katër shtresa të ndërveprimit: ligjore, organizative, semantike dhe teknike;

- një komponent të përbashkët të katër shtresave, “administrimi i shërbimit publik të integruar”;

- një shtresë në bazë të të gjithave, “administrimi i ndërveprimit”.

Modeli paraqitet më poshtë:

Figura 2. Modeli i ndërveprimit



### 3.1 Administrimi i ndërveprimit

Administrimi i ndërveprimit i referohet vendimeve mbi kuadrot e ndërveprimit, strukturat institucionale, strukturat organizative, rolet dhe përgjegjësitë, politikat, marrëveshjet dhe aspektet e tjera të sigurimit dhe monitorimit të ndërveprimit në nivelet kombëtare dhe të BE-së.

Shërbimet publike operojnë në një mjedis të ndërlikuar dhe në ndryshim.

Mbështetja politike është e nevojshme për përpjekjet e ndërveprueshmërisë ndërsektoriale dhe /ose ndërkufitare për të lehtësuar bashkëpunimin mes administratave publike. Për bashkëpunim efektiv, të gjithë palët e interesit duhet të ndajnë një vizion, të bien dakord mbi objektivat dhe afatet kohore dhe të përshtaten prioritetet. Ndërveprueshmëria midis administratave publike në nivele të ndryshme administrative do të jetë e suksesshme vetëm nëse qeveritë japin prioritet të mjaftueshëm dhe caktojnë burime për përpjekjet e tyre përkatëse të ndërveprueshmërisë.

Mungesa e aftësive të brendshme është një pengesë tjetër për zbatimin e politikave të ndërveprueshmërisë. Shtetet duhet të përfshijnë çështjet e ndërveprueshmërisë në strategjitë e tyre, duke pranuar se ndërveprimi është një çështje me shumë dimensione që kërkon ndërgjegjësim dhe aftësi në aspektin ligjor, organizativ, semantik dhe teknik.

Zbatimi dhe ofrimi i një shërbimi publik të caktuar shpesh mbështetet në komponentë që janë të përbashkët për shumë shërbime publike. Qëndrueshmëria e këtyre komponentëve, të cilat mbulohen nga marrëveshjet e ndërveprimit të arritura jashtë fushës së një shërbimi publik të veçantë, duhet të garantohet me kalimin e kohës. Kjo është thelbësore, pasi ndërveprueshmëria duhet të garantohet në një mënyrë të qëndrueshme dhe jo si një objektiv ose projekt i vetëm. Duke qenë se komponentët e përbashkët dhe marrëveshjet e ndërveprimit janë rezultat i punës së bërë nga administratat publike në nivele të ndryshme (lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare), koordinimi dhe monitorimi kërkon një qasje holistike.

Administrimi i ndërveprueshmërisë është çelësi për një qasje holistike ndaj ndërveprimit, pasi sjell së bashku të gjitha instrumentet e nevojshme për ta zbatuar atë.

#### *Rekomandimi 20:*

*Të sigurohet administrim holistik i aktiviteteve të ndërveprimit në të gjitha nivelet dhe sektorët administrativë.*

Koordinimi, komunikimi dhe monitorimi janë të rëndësishëm për një qeverisje të suksesshme. Komisioni Evropian, përmes programit ISA<sup>2</sup>, mbështet një vërtetim të Kornizës Kombëtare të Ndërveprimit (NIFO). Objektivi kryesor i tij është të sigurojë informacion rreth kornizave kombëtare të ndërveprimit dhe strategjive/politikave të lidhura



me ndërveprimet dhe digjitalizimin, për të ndihmuar administratat publike të ndajnë dhe të rikrijojnë përvojat e për të mbështetur “transpozimin” e EIF-së në nivel kombëtar.

### 3.1.1 Identifikimi dhe zgjedhja e standardeve dhe specifikimeve

Standardet dhe specifikimet janë thelbësore për ndërveprimin. Ka gjashtë hapa për menaxhimin e tyre në mënyrë të duhur:

- identifikimi i standardeve dhe specifikimeve të mundshme në bazë të nevojave dhe kërkesave specifike;
- vlerësimi i standardeve dhe specifikimeve të mundshme, duke përdorur metoda të standardizuara, transparente, të drejta dhe jodiskriminuese;
- implementimi i standardeve dhe specifikimeve sipas planeve dhe udhëzimeve praktike;
- monitorimi i përputhshmërisë me standardet dhe specifikimet;
- menaxhimi i ndryshimeve me procedura të duhura;
- dokumentimi i standardeve dhe specifikimeve në katalogë të hapura, duke përdorur një përshkrim të standardizuar.

#### Rekomandimi 21:

*Të vendosen procese për të zgjedhur standardet dhe specifikimet përkatëse, të vlerësohen ato, të monitorohet implementimi i tyre, të kontrollohet përputhshmëria dhe të testohet ndërveprimi i tyre.*

#### Rekomandimi 22:

*Të përdoret një qasje e strukturuar, transparente, objektive dhe e përbashkët për vlerësimin dhe zgjedhjen e standardeve dhe specifikimeve. Të merren parasysh rekomandimet përkatëse të BE-së dhe të tentohet që qasja të jetë konsistente përtej kufijve.*

#### Rekomandimi 23:

*Të konsultohen katalogët përkatës të standardeve, specifikimeve dhe udhëzimeve në nivel kombëtar dhe të BE-së, në përputhje me Kornizën Kombëtare të Ndërveprimit dhe DIF-at përkatëse, kur bëhen dhe zhvillohen zgjidhje TIK.*

Në disa raste, mund të rezultojë se nuk ka standarde/specifikime të përshtatshme për një nevojë specifike në një fushë specifike. Pjesëmarrja aktive në procesin e standardizimit zvogëlon shqetësimet rreth vonësive, përmirëson përputhjen e standardeve dhe specifikimeve me nevojat e sektorit publik dhe mund të ndihmojë qeveritë të mbajnë ritmin me inovacionin teknologjik.

#### Rekomandimi 24:

*Të merret pjesë aktivisht në çështjet e standardizimit të lidhura me nevojat për të siguruar se kërkesat plotësohen.*

### 3.2 Administrimi i shërbimit publik të integruar

Ofrimi i shërbimeve publike shpesh kërkon që administratat e ndryshme publike të punojnë së bashku për të plotësuar nevojat e përdoruesve fundorë dhe të ofrojnë shërbime publike në një mënyrë të integruar. Kur përfshihen organizata të shumta, ka nevojë për koordinim dhe administrim nga autoritetet përgjegjëse për planifikimin, zbatimin dhe operimin e shërbimeve publike. Shërbimet duhet të administrohen për të siguruar: integrimin, ekzekutimin pa pengesa, ripërdorimin e shërbimeve e të dhënave dhe zhvillimin e shërbimeve të reja dhe “bllloqeve ndërtuese”. Më shumë informacion rreth aspekteve të “ofrimit të shërbimeve publike të integruara” gjendet në seksionin 4.3.1.

Duke u fokusuar në pjesën e administrimit, duhet të mbulohen të gjitha shtresat: ligjore, organizative, semantike dhe teknike. Sigurimi i ndërveprimit gjatë përgatitjes së instrumenteve ligjore, proceseve të punës së institucionit, shkëmbimit të informacionit, shërbimeve dhe komponentëve që mbështesin shërbimet publike është një detyrë e vazhdueshme, pasi ndërveprimi shpesh prishet nga ndryshimet në mjedis, pra në legjislacion, nga nevojat e bizneseve ose qytetarëve, struktura organizative e institucioneve publike, proceset e punës dhe nga shfaqja e teknologjive të reja.

Kërkohen, ndër të tjera, struktura organizative, e role dhe përgjegjësi për ofrimin dhe operimin e shërbimeve publike, marrëveshjet e nivelit të shërbimit, hartimin dhe menaxhimin e marrëveshjeve të ndërveprimit, procedurat e menaxhimit të ndryshimeve dhe planet për vazhdimësinë e punës dhe cilësinë e të dhënave.

Administrimi i shërbimit publik i integruar duhet të përfshijë minimalisht:

- përcaktimin e strukturave organizative, roleve dhe përgjegjësi dhe procesit të vendimarrjes për palët e përfshira;
- imponimin e kërkesave, për:
- aspekte të ndërveprimit, duke përfshirë cilësinë, përshkallëzueshmërinë dhe disponueshmërinë e “bllloqeve ndërtuese” të ripërdorshme, përfshi burimet e informacionit (regjistrat bazë, portat e të dhënave të hapura etj.) dhe shërbimet e tjera të ndërlidhura,



- *informacione*/shërbime të jashtme, të përkthyer në marrëveshje të qarta të nivelit të shërbimit (duke përfshirë ndërveprimin),

- një plan ndryshimesh për të përcaktuar procedurat dhe proceset e nevojshme për të trajtuar dhe për të kontrolluar ndryshimet;

- një plan vazhdimësie pune/rikuperimi nga fatkeqësitë për të siguruar, që shërbimet publike digjitale dhe blloqet e tyre ndërtuese, të vazhdojnë të funksionojnë në një gamë situatash, p.sh. sulmet kibernetike ose dështimi i blloqeve ndërtuese.

#### *Rekomandimi 25:*

*Të sigurohet ndërveprimi dhe koordinimi në kohë kur ofrohen shërbime publike të integruara, duke vendosur strukturën e nevojshme të administrimit.*

### **3.2.1 Marrëveshjet e ndërveprimit**

Institucionet e përfshira në ofrimin e shërbimeve publike duhet të kryejnë rregullime formale për bashkëpunim përmes marrëveshjeve të ndërveprimit.

Vendosja dhe menaxhimi i këtyre marrëveshjeve është pjesë e administrimit të shërbimit publik.

Marrëveshjet duhet të jenë të detajuara sa mjaftojnë për të arritur qëllimin e tyre, d.m.th. për të ofruar shërbime publike, ndërsa lë çdo institucion me autonomi të brendshme dhe kombëtare sa më shumë të jetë e mundur.

Në nivelet semantike dhe teknike, por edhe në disa raste në nivelin organizativ, marrëveshjet e ndërveprimit përfshijnë zakonisht standarde dhe specifikime.

Në nivelin ligjor, marrëveshjet e ndërveprimit bëhen specifike dhe detyruese përmes akteve ligjore kombëtare ose përmes marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale.

Lloje të tjera të marrëveshjeve mund të plotësojnë marrëveshjet e ndërveprimit, duke trajtuar çështje operacionale. Për shembull, memorandumet e mirëkuptimit (*MoU*), procedurat e mbështetjes/përshkallëzimit dhe detajet e kontaktit, duke iu referuar, nëse është e nevojshme, marrëveshjeve themelore në nivelet semantike dhe teknike.

Duke qenë se ofrimi i një shërbimi publik është rezultat i punës kolektive me palët, që prodhojnë ose që konsumojnë pjesë të shërbimit, është kritike të përfshihen proceset e duhura të menaxhimit të ndryshimeve në marrëveshjet e ndërveprimit për të siguruar saktësinë, besueshmërinë, vazhdimësinë

dhe evolucionin e shërbimit të ofruar për administratat e tjera publike, bizneset dhe qytetarët.

#### *Rekomandimi 26:*

*Të vendosen marrëveshje të ndërveprimit në të gjitha shtresat, të plotësuara me marrëveshje operacionale dhe procedura të menaxhimit të ndryshimeve.*

### **3.3 Ndërveprueshmëria ligjore**

Çdo administratë publike që kontribuon në ofrimin e një shërbimi publik vepron brenda kuadrit të saj ligjor kombëtar. Ndërveprueshmëria ligjore ka të bëjë me sigurimin, që institucionet që operojnë nën një kuadër ligjor, politika dhe strategji të ndryshme, janë në gjendje të koordinohen së bashku. Në kuadër të integritetit, kjo mund të kërkojë që baza ligjore të mos bllokojë vendosjen e shërbimeve publike brenda vendit dhe atyre ndërkufitare dhe që të ketë marrëveshje të qarta se si të veprohet me ndryshimet e bazave ligjore mes vendeve, duke përfshirë opsionin e vendosjes së legjislacionit të ri.

Hapi i parë drejt adresimit të ndërveprueshmërisë ligjore është të kryejë “kontrolle ndërveprueshmërie”, duke shqyrtuar legjislacionin ekzistues për të identifikuar pengesat e ndërveprimit: kufizime sektoriale ose gjeografike në përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave, modele të ndryshme dhe të paqarta të licencave të të dhënave, detyrime shumë të kufizuara për të përdorur teknologji digjitale specifike ose mënyra dorëzimi për të ofruar shërbime publike, kërkesa kontradiktore për proceset e njëjta ose të ngjashme pune, nevoja të vjetërsuara për siguri dhe mbrojtje të të dhënave etj.

Koherenca midis legjislacionit, me qëllim të sigurimit të ndërveprimit, duhet të vlerësohet para miratimit dhe përmes vlerësimit të rregullt të performancës së tyre sapo ato të vihen në zbatim.

Duke pasur parasysh se shërbimet publike janë qartësisht të destinuara të ofrohen nga kanale digjitale, TIK-u duhet të merret parasysh sa më herët të jetë e mundur në procesin e hartimit të ligjeve. Në veçanti, legjislacioni i propozuar duhet t'i nënshtrohet një “kontrolli digjital”:

- për të siguruar se ai përshtatet në të gjitha kanalet e ofrimit të tij;

- për të identifikuar çdo pengesë për shkëmbimin digjital;

- për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimin e TIK-ut në palët e interesuara.



Kjo do të lehtësojë ndërveprimin midis shërbimeve publike edhe në nivele më të ulëta (semantike dhe teknike), dhe do të rrisë potencialin për të ripërdorur zgjidhjet ekzistuese të TIK-ut, duke reduktuar kështu koston dhe kohën e zbatimit.

Vlera ligjore e çdo informacioni të shkëmbyer midis vendeve duhet të mbahet përtej kufijve dhe duhet të respektohet legjislacioni i mbrojtjes së të dhënave në vendet e origjinës dhe ato pranuese. Kjo mund të kërkojë sipas rasteve, marrëveshje shtesë për të kapërcyer ndonjë vështirësi në zbatimin e legjislacionit.

#### *Rekomandimi 27:*

*Të sigurohet që baza ligjore të kontrollohet përmes “kontrolleve të ndërveprueshmërisë” për të identifikuar çdo pengesë ndaj ndërveprimit. Kur hartohet baza ligjore e një shërbimi publik, të tentohet të bëhet i përputhshëm me bazën ligjore përkatëse, të kryhet një “kontroll digjital” dhe të konsiderohen kërkesat e mbrojtjes së të dhënave.*

### **3.4 Ndërveprueshmëria organizative**

Ky aspekt i ndërveprueshmërisë ka të bëjë me mënyrën se si organizata të ndryshme në vend bashkëpunojnë për të arritur qëllimet e tyre të miratuara bashkërisht. Gjithashtu, i referohet mënyrës se si administratat publike përshtatin proceset e tyre të punës, përgjegjësitë dhe pritshmëritë për të arritur këta objektiva të përbashkët dhe reciprokisht të dobishëm. Në praktikë, ndërveprueshmëria organizative do të thotë dokumentim dhe integrim ose përshtatje e proceseve të punës dhe informacionit përkatës të shkëmbyer. Ndërveprueshmëria organizative synon gjithashtu të plotësojë kërkesat e përdoruesve, duke bërë shërbimet të disponueshme, të identifikueshme lehtësisht, të aksesueshme dhe të fokusuar te përdoruesi.

#### **3.4.1 Përshtatja e proceseve të punës**

Në mënyrë që subjektet administrative të mund të punojnë së bashku në mënyrë efikase dhe efektive për të ofruar shërbime publike, ata mund të kenë nevojë për të lidhur proceset ekzistuese të punës së tyre apo edhe për të përcaktuar dhe për të krijuar procese të reja të punës.

Përafrimi i proceseve të punës nënkupton dokumentimin e tyre, në një mënyrë të sinkronizuar, në mënyrë që të gjithë aktorët e përfshirë, që kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve publike, të mund të kuptojnë procesin e përgjithshëm të biznesit dhe rolin e tyre në të.

#### *Rekomandimi 28:*

*Të dokumentohen proceset e biznesit, duke përdorur teknika modelimi të pranuar gjerësisht dhe të dakordësohet se si duhet të përshtaten këto procese për të ofruar një shërbim publik.*

### **3.4.2 Marrëdhëniet organizative**

Orientimi i shërbimit, për të cilin është ndërtuar modeli konceptual për shërbimet publike, do të thotë se marrëdhëniet midis ofruesve të shërbimit dhe konsumatorëve të shërbimit duhet të përcaktohen qartë.

Kjo përfshin gjetjen e instrumenteve për të formalizuar ndihmën e ndërsjellë, veprim të përbashkët dhe procese të ndërlidhura të punës, si pjesë e ofrimit të shërbimeve, p.sh. marrëveshjet e mirëkuptimit midis aktorëve pjesëmarrës.

Për veprimet ndërkufitare, këto duhet të jenë mundësisht shumëpalëshe.

#### *Rekomandimi 29:*

*Të qartësohen dhe të formalizohen marrëdhëniet organizative për krijimin dhe funksionimin e shërbimeve publike.*

### **3.5 Ndërveprimi semantik**

Ndërveprimi semantik siguron që formati dhe kuptimi i saktë i të dhënave dhe informacionit të shkëmbyer të ruhet dhe të kuptohet gjatë shkëmbimeve ndërmjet palëve, me fjalë të tjera “çfarë dërgohet është ajo që kuptohet”.

Në këtë kornizë, ndërveprimi semantik mbulon si aspektet semantike ashtu edhe ato sintaksore:

Aspekti semantik i referohet kuptimit të elementeve të të dhënave dhe marrëdhënies midis tyre. Ai përfshin zhvillimin e fjalorëve dhe skemave për të përshkruar shkëmbimet e të dhënave dhe siguron që elementet e të dhënave të kuptohen në të njëjtën mënyrë nga të gjitha palët që komunikojnë;

Aspekti sintaksor i referohet përshkrimit të formatit të saktë të informacionit që do të shkëmbehet në terma të gramatikës dhe formatit.

Një pikënisje për të përmirësuar përputhshmërinë semantike është perceptimi i të dhënave dhe informacionit, si një pasuri publike e vlefshme.

#### *Rekomandimi 30:*

*Perceptimi i të dhënave dhe informacionit, si një pasuri publike që duhet të gjenerohet, të mblidhet, të menaxhohet, të ndahet, të mbrohet dhe të ruhet në mënyrë të duhur.*

Duhet të hartohet një strategji e menaxhimit të informacionit dhe koordinohet në nivelin më të lartë





të mundshëm për të shmangur fragmentimin dhe vendosjen e prioriteteve.

Për shembull, marrëveshjet për të dhënat referuese, në formën e taksonomive, fjalorëve të kontrolluar, tezaurusëve, listave të kodit<sup>6</sup> dhe strukturave/ modeleve të të dhënave të përdorshme janë parakushte kyçe për të arritur përputhshmërinë semantike. Qasjet si dizajni, i bazuar në të dhëna, të kombinuara me teknologjitë e të dhënave të lidhura, janë mënyra inovative për të përmirësuar ndjeshëm përputhshmërinë semantike.

#### *Rekomandimi 31:*

*Të vendoset një strategji e menaxhimit të informacionit në nivelin më të lartë të mundshëm për të shmangur fragmentimin dhe përsëritjen. Dubet të ketë prioritet menaxhimi i metadatave, të dhënave kryesore dhe të dhënave referuese.*

Në mënyrë të ngjashme me mënyrën se si standardet teknike kanë nxitur ndërveprimin teknik (p.sh. lidhjen në rrjet), prej dekadash tashmë janë të nevojshme edhe standardet dhe specifikimet e informacionit koherente dhe universale për të mundësuar shkëmbimin kuptimplotë të informacionit midis institucioneve publike.

Duke marrë parasysh mjediset e ndryshme gjuhësore, kulturore, ligjore dhe administrative ndërmjet vendeve, kjo shtesë e ndërveprimit paraqet sfida të mëdha. Megjithatë, nëse përpjekjet për standardizim nuk janë të zhvilluara në shtresën e ndërveprimit semantik, është e vështirë të sigurohet shkëmbimi i paforcuar i informacionit, lëvizja e lirë e të dhënave dhe portabiliteti i të dhënave midis vendeve.

#### *Rekomandimi 32:*

*Të mbështetet krijimi i komuniteteve specifike sektoriale dhe ndërsektoriale, që synojnë të krijojnë specifikime të informacionit të hapur dhe inkurajojnë komunitetet përkatëse të ndajnë rezultatet e tyre në platforma kombëtare dhe ndërkombëtare.*

### **3.6 Ndërveprimi teknik**

Ky përkufizim mbulon aplikacionet dhe infrastrukturën që lidhin sistemet dhe shërbimet. Aspektet e ndërveprimit teknik përfshijnë specifikimet e ndërfaqes, shërbimet e lidhjes në rrjet, shërbimet e integritetit të të dhënave, prezantimin dhe shkëmbimin e të dhënave dhe protokollet e komunikimit të sigurt.

Një pengesë kryesore për ndërveprimin lind nga sistemet e vjetra, të trashëguara.

Historikisht, aplikacionet dhe sistemet e informacionit në administratat publike u zhvilluan fillimisht në një mënyrë nga poshtë lart, duke u përpjekur të zgjidhnin problemet specifike të fushës dhe lokale. Kjo rezultoi në sisteme të fragmentuara të cilat janë e kanë vështirë për të ndërvepruar.

Për shkak të madhësisë së administratës publike dhe fragmentimit të zgjidhjeve të TIK-ut, shumëllojshmëria e sistemeve të trashëguara krijon një pengesë shtesë të ndërveprimit në shtresën teknike.

Ndërveprimi teknik duhet të sigurohet, sa herë që është e mundur, përmes përdorimit të specifikimeve teknike formale.

#### *Rekomandimi 33:*

*Të përdoren specifikime të hapura, kur janë të disponueshme, për të siguruar ndërveprimin teknik kur krijohen shërbimet publike.*

## **4. Modeli konceptual për ofrimin e shërbimeve publike të integruara**

### **4.1 Hyrje**

Ky krye propozon një model konceptual për shërbimet publike të integruara për të udhëzuar planifikimin, zhvillimin, operimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Ai është i rëndësishëm për të gjitha nivelet qeveritare, nga lokale deri në ndërkombëtare. Modeli është modular dhe përfshin komponentë shërbimi të lidhur lirshëm përmes infrastrukturave të përbashkëta.

#### *Rekomandimi 34:*

*Të përdoret modeli konceptual për shërbimet publike për të projektuar shërbime të reja ose për të rindërtuar ato ekzistueset dhe të ripërdoren, sa herë që është e mundur, komponentët ekzistues të shërbimit dhe të dhënave.*

Administratat publike duhet të identifikojnë, negociojnë dhe bien dakord mbi një qasje të përbashkët për ndërlidhjen e komponentëve të shërbimit. Kjo duhet të bëhet në nivele të ndryshme administrative kombëtare sipas strukturës organizative të vendit. Kufizimet e aksesit për shërbimet dhe informacionin duhet të përcaktohen përmes ndërfaqeve dhe kushteve të aksesit.

<sup>6</sup> Për shembull tezaurusi Eurovoc dhe taksonomia e aftësive, kompetencave dhe profesioneve evropiane (ESCO).

**Rekomandimi 35:**

*Të vendoset një skemë e përbashkët për lidhjen e komponentëve të shërbimit, të ndërlidhur në mënyrë fleksibël me njëri-tjetrin, që të krijohet dhe të mirëmbahet infrastruktura e nevojshme për themelimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike.*

Të miratohet një skemë e përbashkët për ndërlidhjen e përbërësve të shërbimit që janë të lidhur në mënyrë të lirshme dhe të vendoset e mirëmbahet infrastruktura e nevojshme për krijimin dhe funksionimin e vazhdueshëm të shërbimeve publike evropiane.


Ekzistojnë zgjidhje teknike të njohura dhe të përdorura gjerësisht, p.sh. shërbimet e internetit për të arritur sa më lart, por implementimi i tyre në nivel ndërkombëtar do të kërkojë përpjekje të koordinuara nga administratat publike pjesëmarrëse, duke përfshirë modele të përbashkëta ose të përputhshme, standarde dhe marrëveshje mbi infrastrukturën e përbashkët.

**4.2 Përmbledhje e modelit**

Modeli konceptual promovon idenë e ndërveprimit që në projektim. Kjo do të thotë, që shërbimet publike të jenë të ndërveprueshme, ato duhet të projektohen në përputhje me modelin e propozuar dhe me disa kërkesa të përputhshmërisë dhe ripërdorimit.

Modeli promovon ripërdorimin si bazën e ndërveprimit, duke pasur në konsideratë se shërbimet publike duhet të ripërdorin informacionin dhe shërbimet që tashmë ekzistojnë dhe mund të jenë të disponueshme nga burime të ndryshme brenda ose jashtë kufijve organizativë të administratave publike. Informacioni dhe shërbimet duhet të jenë të aksesueshme dhe të bëhen të disponueshme në formate ndërvepruese.

Komponentët bazë të modelit konceptual prezantohen më poshtë.

**Figura 3 Modeli Konceptual**

Struktura e modelit përfshin:

- “dorëzim i shërbimit të integruar”, bazuar në një “funksion koordinimi” për të hequr kompleksitetin për përdoruesin e fundit;
- një politikë të ofrimit të shërbimeve sipas parimit “pa derë të gabuar”, e cila siguron mundësi dhe kanale alternative për ofrimin e shërbimeve, duke garantuar njëkohësisht disponueshmërinë e kanaleve digjitale (digjitale si parazgjedhje);

- ripërdorimi i të dhënave dhe shërbimeve për të zvogëluar kostot dhe për të rritur cilësinë e shërbimit dhe ndërveprimit;

- katalogë që përshkruajnë shërbimet e ripërdorshme dhe asetet e tjera për të rritur gjetjen dhe përdorimin e tyre;

- administrimi i shërbimit publik të integruar;

- siguria dhe privatësia.



### 4.3 Komponentët bazë

#### 4.3.1 Funksioni i koordinimit

Funksioni i koordinimit siguron që të identifikohen nevojat, të thirren shërbimet e duhura dhe të orkestrohen për të ofruar një shërbim publik. Ky funksion duhet të zgjedhë burimet dhe shërbimet e duhura e t'i integrojë ato.

Koordinimi mund të jetë automatik ose manual. Fazat e mëposhtme të procesit janë pjesë e “ofrimit të shërbimeve publike të integruara” dhe ekzekutohen nga funksioni i koordinimit.

- *Identifikimi i nevojave*: nxitet nga një kërkesë për shërbim publik nga një qytetar ose biznes.

- *Planifikimi*: përfshin identifikimin e shërbimeve dhe burimeve të informacionit të nevojshme, duke përdorur katalogët e disponueshëm dhe duke i grumbulluar ato në një proces të vetëm, duke marrë parasysh nevojat specifike të përdoruesit (p.sh. personalizim).

- *Ekzekutimi*: përfshin mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit, zbatimin e rregullave të punës (siç kërkohet nga legjislacioni dhe politikat përkatëse) për të dhënë ose për të refuzuar qasjen në një shërbim dhe më pas ofrimin e shërbimit të kërkuar për qytetarët ose bizneset.

- *Vlerësimi*: Pas ofrimit të shërbimit mblidhen reagimet e përdoruesve dhe vlerësohen.

#### 4.3.2 Burimet dhe shërbimet e brendshme të informacionit

Administratat publike prodhojnë dhe ofrojnë një numër të madh shërbimesh, ndërsa mbajnë dhe menaxhojnë një numër të madh dhe llojllojshmëri burimesh informacioni. Këto burime informacioni shpesh janë të panjohura jashtë kufijve të një administrate të caktuar (dhe ndonjëherë edhe brenda atyre kufijve).

Rezultati është përsëritja e përpjekjeve dhe shfrytëzimi jo i mjaftueshëm i burimeve dhe zgjidhjeve të disponueshme.

Burimet e informacionit (regjistrat bazë, portat e të dhënave të hapura, dhe burimet e tjera të besueshme të informacionit) dhe shërbimet e disponueshme jo vetëm brenda sistemit administrativ por edhe në mjedisin e jashtëm, mund të përdoren për të krijuar shërbime publike të integruara si “bllloqe ndërtimi”. Bllloqet e ndërtimit (burimet e informacionit dhe shërbimet) duhet të bëjnë të aksesueshme të dhënat ose funksionalitetin e tyre, duke përdorur qasjet e orientuara ndaj shërbimit.

#### Rekomandimi 36:

*Të zhvillohet një infrastrukturë e përbashkët dhe e ripërdorshme e shërbimeve dhe burimeve të informacionit, që mund të përdoren nga të gjitha institucionet publike.*

Institucionet publike duhet të promovojnë politikat për ndarjen e shërbimeve dhe burimeve të informacionit në tri mënyra kryesore.

1. *Ripërdorimi*: Kur projektohen shërbime të reja ose rishikohen ato ekzistuese, hapi i parë duhet të jetë analiza nëse shërbimet dhe burimet e informacionit ekzistuese mund të ripërdoren;

2. *Publikimi*: Kur projektohen shërbime dhe burime të reja të informacionit ose rishikohen ato ekzistuese, shërbimet dhe burimet e informacionit të ripërdorshme duhet të bëhen të disponueshme për të tjerët për ripërdorim;

*Agregimi*: Pasi të jenë identifikuar shërbimet dhe burimet e përshtatshme të informacionit, ato duhet të agregohen për të formuar një proces të integruar të ofrimit të shërbimit. Bllloqet ndërtuese duhet të tregojnë aftësi të natyrshme të kombinimit (“ndërveprim që në projektim”), për të qenë gati për përdorim në mjedise të ndryshme me përshtatje minimale. Ky agregim është i rëndësishëm për informacionin, shërbimet dhe zgjidhjet e tjera të ndërveprimit (p.sh. *software*).

Qasja e përdorimit të përbërësve të ripërdorshëm gjen zbatim të përshtatshëm përmes hartëzimit të zgjidhjeve kundrejt përbërësve konceptualë të një arkitekture referuese, e cila mundëson identifikimin e përbërësve të ripërdorshëm dhe njëkohësisht nxit racionalizimin. Rezultati i këtij hartëzimi është një kartografi e zgjidhjeve, përfshirë përbërësit e tyre përkatës, të cilët mund të ripërdoren për të përmbushur nevoja të përbashkëta funksionale dhe për të siguruar ndërveprueshmërinë.

Për të shmangur përsëritjen e përpjekjeve, kostot shtesë dhe problemet e mëtejshme të ndërveprimit, duke rritur cilësinë e shërbimeve të ofruara, modeli konceptual përmban dy lloje të ripërdorimit.

- *Ripërdorimi i shërbimeve*: Lloje të ndryshme të shërbimeve mund të ripërdoren. Shembujt përfshijnë shërbimet publike bazë, p.sh. lëshimi i një certifikate lindjeje dhe shërbimet e përbashkëta, si identifikimi elektronik dhe nënshkrimi elektronik. Shërbimet e përbashkëta mund të ofrohen nga sektori publik, sektori privat ose në modele të partneritetit publik-privat (PPP);

- *Ripërdorimi i informacionit*: Administratat publike tashmë ruajnë sasi të mëdha informacioni me



potencial për ripërdorim. Shembujt përfshijnë: të dhënat kryesore nga regjistrat bazë, si të dhëna të besueshme të përdorura nga aplikacione dhe sisteme të shumta; të dhënat e hapura nën licenca të hapura të përdorimit të publikuara nga organizatat publike; lloje të tjera të të dhënave të besueshme të vlefshme dhe të menaxhuara nën ombrellën e autoriteteve publike. Regjistrat bazë dhe të dhënat e hapura trajtohen më thellësisht në seksionin e ardhshëm.

#### 4.3.3 Regjistrat bazë

Regjistrat bazë janë themeli i ofrimit të shërbimeve publike. Një regjistër bazë është një burim i besueshëm i informacionit, i cili mund dhe duhet të përdoret elektronikisht nga të tjerët, ku një institucion është përgjegjës dhe përgjigjet për mbledhjen, përdorimin, përditësimin dhe ruajtjen e informacionit.

Regjistrat bazë janë burime të besueshme të informacionit bazë për të dhënat e njerëzve dhe sendeve, si të dhëna për personat, bizneset, automjetet, licencat, ndërtesat, vendndodhjet dhe rrugët. Ky lloj informacioni përbën “të dhënat kryesore” për institucionet publike dhe ofrimin e shërbimeve publike. “I besueshëm” këtu do të thotë se një regjistër bazë konsiderohet si “burimi” i informacionit, pra tregon statusin e saktë, është i përditësuar dhe ka cilësinë dhe integritetin më të lartë të mundshëm.

Në rastin e regjistrave të qendëruar, një entitet organizativ i vetëm është përgjegjës dhe përgjigjet për sigurimin e cilësisë së të dhënave dhe për vendosjen e masave për të siguruar korrektësinë e të dhënave. Këta regjistra janë nën kontrollin ligjor të administratave publike, ndërsa funksionimi dhe mirëmbajtja mund të jepen me kontratë jashtë institucionit nëse kërkohet. Ekzistojnë disa lloje të regjistrave bazë, p.sh. popullsia, bizneset, automjetet, kadastrat. Për administratat, është e rëndësishme të kenë një pasqyrë të nivelit të lartë të funksionimit të regjistrave bazë dhe të të dhënave që ato ruajnë (një regjistër i regjistrave).

Në rast të regjistrave të shpërndarë duhet të ketë një entitet organizativ të vetëm përgjegjës dhe që përgjigjet për çdo pjesë të regjistratit. Gjithashtu, një entitet i vetëm duhet të jetë përgjegjës dhe të përgjigjet për koordinimin e të gjitha pjesëve të regjistratit të shpërndarë.

Një kuadër i regjistrave bazë, “përshkruan marrëveshjet dhe infrastrukturën për funksionimin

e regjistrave bazë dhe marrëdhëniet me entitetet e tjera”.

Qasja në regjistrat bazë duhet të rregullohet për të përmbushur privatësinë dhe rregulloret e tjera; regjistrat bazë udhëhiqen nga parimet e administrimit të informacionit.

Administruesi i informacionit është organi (ose ndoshta individ) përgjegjës dhe që përgjigjet për mbledhjen, përdorimin, përditësimin, mirëmbajtjen dhe fshirjen e informacionit. Këtu përfshihet përcaktimi mbi përdorimin e lejuar të informacionit, përmbushja e rregulloreve të privatësisë dhe politikave të sigurisë, sigurimi që informacioni është aktual dhe sigurimi i aksesit të të dhënave nga përdoruesit e autorizuar.

Regjistrat bazë duhet të hartojnë dhe të zbatojnë një plan për sigurimin e cilësisë së të dhënave. Qytetarët dhe bizneset duhet të jenë në gjendje të kontrollojnë saktësinë, korrektësinë dhe plotësinë e çdo të dhëne të tyre, të përmbajtura në regjistrat bazë.

Duhet të jetë i disponueshëm një udhëzues për terminologjinë e përdorur dhe/ose një fjalor i termave të përdorura në çdo regjistër bazë për qëllime informacioni të lexueshme nga njerëzit dhe kompjuterët.

#### *Rekomandimi 37:*

*Të vihen në dispozicion të të tjerëve burime të besueshme dhe zyrtare të informacionit, duke zbatuar mekanizmat përkatës të aksesit dhe kontrollit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe privatësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

#### *Rekomandimi 38:*

*Të zhvillohen ndërfaqe me regjistrat bazë dhe burimet e besueshme të informacionit, të publikohen mjetet semantike e teknike dhe dokumentacioni i nevojshëm për të tjerët për të lidhur e për të ripërdorur informacionin e disponueshëm.*

#### *Rekomandimi 39:*

*Të përshtatet çdo regjistër bazë me metadata të përshtatshme duke përfshirë përshkrimin e përmbajtjes së tij, sigurimin e shërbimit dhe përgjegjësitë, llojin e të dhënave kryesore që mban, kushtet e aksesit dhe licencat përkatëse, terminologjinë, një fjalor dhe informacionin rreth çdo të dhëne kryesore që merr nga regjistrat e tjera bazë.*

#### *Rekomandimi 40:*

*Të krijohen dhe të ndiqen plane për sigurimin e cilësisë së të dhënave për regjistrat bazë dhe të dhënat kryesore të lidhura.*

#### 4.3.4 Të dhëna të hapura

Udhëzimi për rishfrytëzimin e informacionit të sektorit publik ofron një kuadër ligjor të përbashkët për rishfrytëzimin e të dhënave të sektorit publik.



Fokusi është në publikimin e të dhënave të lexueshme nga kompjuterët për përdorim nga të tjerët për të stimuluar transparencën, konkurrencën e drejtë, inovacionin dhe një ekonomi të drejtuar nga të dhënat. Për të siguruar kushte të barabarta, hapja dhe rishfrytëzimi i të dhënave duhet të jetë jodiskriminues, që do të thotë se të dhënat duhet të jenë të ndërveprueshme, në mënyrë që të gjenden, të zbulohen dhe të përpunohen.

#### *Rekomandimi 41:*

*Të vendosen procedura dhe procese për të integruar hapjen e të dhënave në proceset e përbashkëta të punës, punën e përditshme dhe në zhvillimin e sistemeve të reja të informacionit.*

Aktualisht ka shumë pengesa për përdorimin e të dhënave të hapura. Shpesh publikohen në formate të ndryshme ose formate që pengojnë përdorimin e lehtë, mund të mungojnë metadatat e duhura, vetë të dhënat mund të jenë të cilësisë së ulët, etj. Idealja është që metadatat bazë dhe semantika e seteve të të dhënave të hapura të përshkruhen në një format standard të lexueshëm nga kompjuterët.

#### *Rekomandimi 42:*

*Të publikohen të dhëna të hapura në formate të lexueshme nga makinat dhe jopronësore. Të sigurohet që të dhënat e hapura të shfaqen me metadatat me cilësi të lartë, të lexueshme nga makinat dhe në formate jopronësore, duke përfshirë një përshkrim të përmbajtjes së tyre, mënyrën e mbledhjes së të dhënave, nivelin e cilësisë dhe kushtet e licencës sipas së cilës ato vihen në dispozicion. Rekomandohet përdorimi i fjalorëve të përbashkët për përshkrimin e metadatave.*

Të dhënat mund të përdoren në mënyra të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme dhe publikimi i të dhënave të hapura duhet të lejojë këtë. Megjithatë, përdoruesit mund të gjejnë probleme me setet e të dhënave, mund të komentojnë mbi cilësinë e tyre ose mund të preferojnë mënyra të tjera të publikimit. Mekanizmat e mbledhjes së opinionit mund të ndihmojnë për të zbuluar më shumë rreth mënyrës se si përdoren setet e të dhënave dhe si të përmirësohet publikimi i tyre.

Për të arritur potencialin e plotë të përdorimit të të dhënave të hapura, është thelbësor ndërveprimi ligjor dhe siguria. Për këtë arsye, e drejta për çdo person për të përdorur të dhënat e hapura duhet të komunikohet qartë në nivel kombëtar, si dhe duhet të promovohen dhe të standardizohen sa më shumë të jetë e mundur bazat ligjore për të lehtësuar përdorimin e të dhënave, si licencat.

#### *Rekomandimi 43:*

*Të komunikohet qartë e drejta për të aksesuar dhe përdorur të dhënat e hapura. Bazat ligjore për të lehtësuar aksesin dhe përdorimin, si licencat, duhet të standardizohen sa më shumë të jetë e mundur.*

#### **4.3.5 Katalogët**

Katalogët ndihmojnë të tjerët të gjejnë burime të ripërdorshme (p.sh. shërbime, të dhëna, *software*, modele të dhënash). Ekzistojnë lloje të ndryshme të katalogëve, p.sh. direktoritë e shërbimeve, bibliotekat e komponentëve *software*, portalet e të dhënave të hapura, regjistrat e regjistrave bazë, katalogët e metadatave, katalogët e standardeve, specifikimeve dhe udhëzimeve.

Përshkrimet e përbashkëta të shërbimeve, të dhënave, regjistrave dhe zgjidhjeve të ndërveprimit të publikuara në katalogë janë të nevojshme për të mundësuar ndërveprimin midis katalogëve.

Një lloj specifik i katalogut është Hartografia Evropiane e Ndërveprimit (EIC), e cila përmban zgjidhje ndërveprimi në dispozicion për ripërdorim dhe shpërndarje.

#### *Rekomandimi 44:*

*Të krijohen katalogë të shërbimeve publike, të dhënave publike dhe zgjidhjeve të ndërveprimit dhe të përdoren modele të përbashkëta për t'i përshkruar ato.*

#### **4.3.6 Burimet dhe shërbimet e informacionit të jashtëm**

Administratat publike duhet të shfrytëzojnë, aty ku është e mundur, shërbimet e ofruara jashtë kufijve të organizatës së tyre nga palët e treta, si shërbimet e pagesave të ofruara nga institucionet financiare ose shërbimet e lidhjes së ofruara nga ofruesit e telekomunikacioneve. Ata duhet të shfrytëzojnë gjithashtu burimet e jashtme të informacionit si të dhënat e hapura dhe të dhënat nga organizatat ndërkombëtare, dhomat e tregtisë etj.

Për më tepër, të dhëna të dobishme mund të mblidhen përmes internetit të sendeve (p.sh. përmes sensorëve) dhe aplikacioneve të rrjeteve sociale.

#### *Rekomandimi 45:*

*Aty ku është e mundur, e dobishme dhe e zbatueshme, të përdoren burimet dhe shërbimet e jashtme të informacionit gjatë zhvillimit të shërbimeve publike.*

#### **4.3.7 Siguria dhe privatësia**

Siguria dhe privatësia janë shqetësimet kryesore në ofrimin e shërbimeve publike.

Administrata publike duhet të sigurojë, se:



- ato ndjekin qasjen e privatësisë që në projektim dhe sigurisë që në projektim për të siguruar gjithë infrastrukturën e tyre dhe blloqet ndërtuese;

- shërbimet nuk janë të prekshme nga sulmet që mund të ndërpresin funksionimin e tyre dhe të shkaktojnë vjedhje të të dhënave ose dëmtime të të dhënave;

- ato janë në përputhje me kërkesat dhe detyrimet ligjore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë duke njohur rreziqet për privatësinë nga përpunimi i avancuar i të dhënave dhe analitika.

Ajo duhet të sigurojë po ashtu që kontrolluesit të jenë në përputhje me ligjin e mbrojtjes së të dhënave, duke mbuluar pikat e mëposhtme:

- “Planet e menaxhimit të rrezikut” për të identifikuar rreziqet, vlerësuar ndikimin e tyre të mundshëm dhe planifikuar përgjigjet me masa teknike dhe organizative të përshtatshme. Bazuar në zhvillimet më të fundit teknologjike, këto masa duhet të sigurojnë që niveli i sigurisë të jetë në përputhje me gradën e rrezikut;

- “Planet e vazhdueshmërisë së punës” dhe “Planet e rikthimit dhe rimëkëmbjes” për të vendosur procedurat e nevojshme, që gjithçka të funksionojë pas një ngjarjeje katastrofike dhe të kthehen të gjitha funksionet në normalitet sa më shpejt të jetë e mundur;

- Një “plan i aksesimit dhe autorizimit të të dhënave”, që përcakton kush ka akses në cilat të dhëna dhe në cilat kushte, për të garantuar privatësinë. Aksesit i paautorizuar dhe shkeljet e sigurisë duhet të monitorohen dhe duhet të merren masa të përshtatshme për të parandaluar çdo përsëritje të shkeljeve;

- Përdorimi i shërbimeve të besuara në përputhje me rregulloren *eIDAS*<sup>7</sup> për të garantuar integritetin, autenticitetin, konfidencialitetin dhe mosrefuzimin e të dhënave.

Kur administratat publike dhe entitetet e tjera shkëmbejnë informacione zyrtare, informacioni duhet të transferohet, në varësi të kërkesave të sigurisë, përmes një rrjeti të sigurt, të harmonizuar, të menaxhuar dhe të kontrolluar. Mekanizmat e transferimit duhet të lehtësojnë shkëmbimet e informacionit midis administratave, bizneseve dhe qytetarëve që janë:

- të regjistruar dhe të verifikuar, në mënyrë që dërguesi dhe marrësi të jenë të identifikuar dhe të

autentifikuar përmes procedurave dhe mekanizmave të dakordësuar;

- të enkriptuar, në mënyrë që të sigurohet konfidencialiteti i të dhënave të shkëmbyera;

- me vulë kohore, për të ruajtur kohën e saktë të transferimit dhe aksesit të regjistrimeve elektronike;

- të regjistruar, në mënyrë që regjistrimet elektronike të arkivohen, duke siguruar kështu një gjurmë të ligjshme për auditim.

Mekanizmat e duhur duhet të lejojnë shkëmbimin e sigurt të mesazheve, regjistrimeve, formave dhe llojeve të tjera të informacionit të verifikuar elektronikisht midis sistemeve të ndryshme; duhet të trajtojnë kërkesat specifike të sigurisë dhe identifikim elektronik dhe shërbimet e besuara, si krijimin dhe verifikimin e nënshkrimeve/vulave elektronike; dhe duhet të monitorojnë trafikun për të zbuluar hyrjet, ndryshimet e të dhënave dhe lloje të tjera të sulmeve.

Informacioni duhet të mbrohet gjithashtu në mënyrë të duhur gjatë transmetimit, përpunimit dhe ruajtjes nga procese të ndryshme të sigurisë, si:

- përcaktimi dhe zbatimi i politikave të sigurisë;

- trajnimi dhe ndërgjegjësimi për sigurinë;

- siguria fizike (përfshirë kontrollin e aksesit);

- siguria gjatë procesit të zhvillimit;

- siguria gjatë procesit të funksionimit (përfshirë monitorimin e sigurisë, trajtimin e incidenteve, menaxhimin e dobësive);

- analizat e sigurisë (përfshirë auditimet dhe kontrollet teknike).

Ofrimi i shkëmbimit të të dhënave të sigurt kërkon gjithashtu disa funksione menaxhimi, duke përfshirë:

- menaxhimin e shërbimit për të mbikëqyrur të gjitha komunikimet për identifikimin, autentifikimin, autorizimin, transportin e të dhënave etj., duke përfshirë autorizimet e qasjes, revokimin dhe auditimin;

- regjistrimin e shërbimit për të ofruar, në përputhje me autorizimin e duhur, qasje në shërbimet e disponueshme përmes lokalizimit të mëparshëm dhe verifikimit se shërbimi është i besueshëm;

- regjistrimin e shërbimit për të siguruar se të gjitha shkëmbimet e të dhënave janë regjistruar për referencë të ardhshme dhe arkivohen kur është e nevojshme.

<sup>7</sup> Rregullorja (BE) nr.910/ 2014.

**Rekomandimi 46:**

*Të merren parasysh kërkesat specifike të sigurisë dhe privatësisë dhe të identifikohen masat për ofrimin e çdo shërbimi publik sipas planeve të menaxhimit të rrezikut.*

**Rekomandimi 47:**

*Të përdoren shërbimet e besuara sipas rregullores mbi eID dhe shërbimet e besuara si mekanizma që sigurojnë shkëmbimin e të dhënave të sigurta dhe të mbrojtura në shërbimet publike.*

**5. Përfundim**

Në dekadat e fundit, administrata publike ka investuar në TIK për të modernizuar operacionet e saj të brendshme, për të ulur kostot dhe për të përmirësuar shërbimet që ofron për qytetarët dhe bizneset. Pavarësisht progresit të konsiderueshëm të arritur dhe përfitimeve të përfituara tashmë, administratat ende mund të ketë pengesa për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin elektronik.

Këto përfshijnë pengesa ligjore, procese biznesi dhe modele informacioni të papërpunueshme dhe diversitetin e teknologjive të përdorura. Kjo ndodh sepse, historikisht, sistemet e informacionit u vendosën në sektorin publik në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri dhe jo në një mënyrë të koordinuar.

Ndërveprimi është një parakusht për të mundësuar komunikimin elektronik dhe shkëmbimin e informacionit midis institucioneve publike. Kjo e bën atë gjithashtu një parakusht për të arritur një treg të vetëm digjital, jashtë kufijve.

Administrimi, përputhshmëria e bazave ligjore, përshtatja e proceseve të punës dhe aksesimi i sigurt në burimet e të dhënave janë disa nga çështjet që duhet të trajtohen më tej për të ofruar shërbime publike plotësisht të zhvilluara.


Kjo kornizë ndërveprimi promovon komunikimin elektronik midis institucioneve publike, duke ofruar një set modelesh, parimesh dhe rekomandimesh të përbashkëta.

Ajo njeh dhe thekson faktin se ndërveprimi nuk është vetëm një çështje e TIK-ut, pasi ka elemente të tjera që variojnë nga ato ligjore deri tek ato teknike. Trajtimi i çështjeve në një mënyrë holistike në të gjitha këto shtresa dhe në nivele të ndryshme administrative nga lokale deri në ndërkombëtare mbetet sfida.

Korniza identifikon katër shtresa të sfidave të ndërveprimit (ligjore, organizative, semantike dhe teknike), duke treguar në të njëjtën kohë rolin thelbësor të qeverisjes për të siguruar koordinimin e aktiviteteve përkatëse në të gjitha nivelet dhe sektorët e administratës.

Modeli konceptual i kësaj kornize për shërbimet publike mbulon projektimin, planifikimin, zhvillimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike të integruara në të gjitha nivelet qeveritare, nga niveli lokal deri në nivel ndërkombëtar. Parimet e përcaktuara këtu udhëzojnë vendimmarrjen për themelimin e shërbimeve publike të ndërveprueshme.

*Figura 4: Marrëdhëniet e modelit konceptual të kornizës*



Kjo kornizë është një instrument kyç për krijimin e shërbimeve publike elektronike të ndërveprueshme në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, duke kontribuar drejt tregut të vetëm digjital.



**VENDIM****Nr. 224, datë 17.4.2025****PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SUEDISË, LIDHUR ME FAZËN E TRETË TË PROGRAMIT PËR FORCIMIN E POLICIMIT NË KOMUNITET NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Suedisë, lidhur me fazën e tretë të programit për forcimin e policimit në komunitet në Shqipëri, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

**MARRËVESHJE GRANTI**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE**  
**SUEDISË, LIDHUR ME FAZËN E TRETË TË**  
**PROGRAMIT PËR FORCIMIN E POLICIMIT**  
**NË KOMUNITET NË SHQIPËRI**

Kontributi i SIDA-s nr. 15636

\*\*\*

Versioni 1.2 i nëntorit 2024

**Përmbajtja**

1. Objekti dhe Informacion mbi Historikun
2. Objektivat e Programit
3. Zbatimi
4. Granti
5. Disbursimet
6. Menaxhimi financiar
7. Raportimi financiar
8. Raportimi narrativ

9. Prokurimi
10. Monitorimi
11. Takimet vjetore
12. Vlerësimet
13. Auditimet
14. Shlyerja e interesit, fitimet nga këmbimi dhe fondet e papërdorura
15. Korrupsioni dhe parregullsia të tjera
16. Shfrytëzimi seksual, abuzimi seksual dhe ngacmimi seksual
17. Rregullimet ligjore
18. Vizibiliteti dhe informacioni
19. Referimi në marrëveshje të tjera
20. Përfundimi
21. Periudha e vlefshmërisë së marrëveshjes
22. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
23. Njoftime

Kjo Marrëveshje Granti (Marrëveshja) është lidhur ndërmjet

1. Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Brendshme (“Përfituesi”);

dhe

2. Suedisë, të përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim, SIDA (“Suedi”) për Programin “Faza e tretë – Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri”, të referuara bashkërisht si Palët.

**1. Objekti dhe informacion mbi historikun**

1.1 Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë i ka kërkuar Suedisë të kontribuojë në zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Sigurinë në Komunitet 2021–2026 nëpërmjet financimit të fazës së tretë të Programit për Forcimin e Policimit në Komunitet në Shqipëri” (Projekti/Programi).

1.2 Financimi i Programit nga Përfituesi pasqyrohet në buxhetin e shtetit të Përfituesit.

1.3 Suedia ka vendosur të japë një grant prej 36 MSEK që do të përdoret ekskluzivisht për zbatimin e Programit gjatë periudhës nga data 20 korrik 2024 deri më 19 qershor 2029 (Periudha e Aktivitetit). Financimi suedez do të përdoret plotësisht për prokurimin e një partneri që do të zbatojë Programin.

1.4 Palët kanë rënë dakord të lidhin një Marrëveshje, e cila përbëhet nga këto Kushte Specifike dhe anekset e mëposhtme, të cilat të gjitha janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe janë renditur sipas prioritetit. Në rast të mospërputhjeve





ndërmjet Kushteve Specifike dhe anekseve, Kushtet Specifike do të kenë përparësi.

Anekset

A. Dokumenti i Programit

1.5 Palët do të bashkëpunojnë dhe do të komunikojnë rregullisht me njëra-tjetrën për të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e Programit dhe kësaj Marrëveshjeje. Palët do të informojnë pa vonesë njëra-tjetrën për çdo rrethanë që mund të ndërhyjë ose rrezikon të ndërhyjë në zbatimin e suksesshëm të Programit dhe ndryshime të tjera, me qëllim zgjidhjen e çështjes. Palët do të mbajnë takime nëse, ose kur kërkohet nga secila palë.

## 2. Objektivat e Programit

2.1 Objektivi i përgjithshëm i Programit është “Përmirësimi i besimit dhe partneritetit ndërmjet policisë dhe komunitetit, kontribuon në fqinjësi më të sigurt”, siç përshkruhet në dokumentin e programit të titulluar “Propozimi i programit: Faza e tretë - Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri” (SCPA 3), duke përfshirë buxhetin në monedhën euro, datë 17.7.2023 (Dokumenti i Programit), shtojca A.

2.2 Dokumenti i Programit, si dhe buxheti do të përditësohen me ndryshime me shkrim, sa herë që kërkohen ndryshime të rëndësishme në Kuadrin e Rezultateve të Projektit/Programit për zbatimin efektiv, duke marrë parasysh performancën buxhetore, stabilitetin e burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit shqiptar, si përfitues i drejtpërdrejtë, dhe programe të reja të mundshme ndërkombëtare që kontribuojnë në të njëjtat fusha si SCPA 3. Ndryshimet e kërkuara do të paraqiten për miratim te SIDA/Ambasada Suedeze, pasi të diskutohen ndërmjet Policisë së Shtetit shqiptar (PSH) (përfituesi kryesor) dhe konsulentit zbatues (partneri bashkëpunues), dhe miratohen në Komitetin Drejtues të Programit.

## 3. Zbatimi

3.1 Si financuese, Suedia nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi dhe/ose detyrim ndaj asnjë pale të tretë, në lidhje me zbatimin e Projektit/Programit, përveç konsulentit zbatues.

3.2 Përfituesi ka autorizuar Ministrinë e Brendshme që të jetë përgjegjëse ndaj Përfituesit për zbatimin e Projektit/Programit.

## 4. Granti

4.1 Suedia merr përsipër të financojë Programin, duke prokuruar një partner/konsulent zbatimi deri në një shumë maksimale prej 36 000 000 SEK

(tridhjetë e gjashtë milionë korona suedeze) (Granti), në bazë të caktimit të kësaj shume nga parlamenti suedez.

4.2 Granti do të përdoret vetëm për të financuar kostot aktuale të zbatimit të Programit gjatë periudhës së aktivitetit.

4.3 Përfituesi është përgjegjës për të siguruar çdo burim shtesë që mund të kërkohet për zbatimin e duhur të Projektit/Programit. Kjo duhet të pasqyrohet në buxhet dhe të përfshihet në raportim.ëë. Në përputhje me Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Suedisë mbi Afatet dhe Kushtet e Përgjithshme të Bashkëpunimit për Zhvillim, të ratifikuar me ligjin nr. 9608, datë 18.9.2006, fondet e financuara në kuadër të këtij Projekti nuk do të përdoren për të paguar tatimin mbi vlerën e shtuar.

## 5. Disbursimet

5.1 Granti do të disbursohet me pagesën e faturave nga konsulenti zbatues i prokuruar, bazuar në shpenzimet e Programit.

## 6. Menaxhimi financiar

E pazbatueshme

## 7. Raportimi financiar

7.1 Konsulenti zbatues do t'i sigurojë Suedisë dhe Ministrisë së Brendshme pasqyrat financiare gjashtëmujore dhe raportet financiare që do të përfshijnë informacion mbi shumën e marrë. Raporti do të përfshijë, gjithashtu, informacion mbi shpenzimet totale, të zbërthyer/të analizuar, në përputhje me zërat e buxhetit të rënë dakord, për periudhën raportuese, si dhe shumat e akumuluar për të gjithë periudhën e Programit.

## 8. Raportimi narrativ

8.1 Përfituesi dhe Suedia do të marrin me shkrim një raport narrativ/gjashtëmujor nga konsulenti zbatues çdo vit.

8.2 Raporti narrativ do të përmbajë një analizë të progresit të aktiviteteve të Programit dhe rezultateve të pritshme, duke ndjekur strukturën e Dokumentit të Programit, siç është përpunuar më tej në planet vjetore të punës.

8.3 Raportet do të mbulojnë periudhat përkatëse gjashtëmujore nga fillimi i Programit. Raporti gjashtëmujor do të përmbajë përshkrim, mbi baza kumulative, i cili mbulon të gjithë periudhën e Programit, për sa u përket:

- aktiviteteve të realizuara gjatë periudhës së raportimit;



- rezultateve të arritura në krahasim me rezultatet e planifikuara;

- rezultatit/eve të objektivit/objektivave të arritur të krahasuar me objektivin/objektivat e rezultateve të planifikuara (ose progresin drejt arritjes së objektivit/objektivave të rezultateve dhe një vlerësim të mundësisë për arritjen e objektivave të rezultateve të planifikuara;

- një vlerësim të faktorëve të riskut që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave; dhe

- një vlerësim të përshtatjeve/rregullimeve të mundshme në zbatimin e Programit, duke përfshirë menaxhimin e riskut.

Përfituesi do ta bëjë publik të njëjtin informacion ndaj grupit të synuar, me qëllim që të rrisë transparencën përmes (ndër të tjera) takimit vjetor për të provuar progresin e Programit, për të debatuar dhe për të diskutuar çështjet e zhvillimit të sigurisë dhe drejtësisë, për të marrë reagime nga përfituesit e Programit dhe për të identifikuar prioritetet e ardhshme të Programit.

Përfituesi dhe Suedia do të marrin me shkrim një raport përfundimtar për përfundimin e Programit. Raporti përfundimtar do të përmbajë përshkrim, mbi baza kumulative, i cili mbulon të gjithë periudhën e aktivitetit, për:

- rezultatet e arritura në krahasim me rezultatet e planifikuara;

- objektivin/objektivat e rezultateve të arritura në krahasim me objektivin/objektivat e rezultateve të planifikuara;

- një vlerësim të faktorëve që kanë ndikuar në arritjen e objektivave;

- mësimet e nxjerra nga zbatimi i Programit/Projektit; dhe

- një vlerësim të nevojave të mundshme për rregullime në Program, duke përfshirë veprimet që lehtësojnë riskun.

Përfituesi do të bëjë publik të njëjtin informacion për grupin e synuar, në mënyrë që të rrisë transparencën përmes një seminari/eventi përmbyllës ku rezultatet dhe trashëgimia e Programit do të prezantohen dhe ndahen me palët e interesuara dhe publikun.

8.4 Përfituesi do t'i ofrojë Suedisë çdo informacion të rëndësishëm për zbatimin e Programit, siç mund të kërkohet nga Suedia.

## 9. Prokurimi

9.1 Nuk do të ketë asnjë prokurim me financim të Programit që do të kryhet nga Përfituesi gjatë

zbatimit të Projektit/Programit. Konsulenti Zbatues që do të prokurohet nga Suedia, do të kryejë të gjitha prokurimet që do të kërkohen për Programin dhe në përfitim të Përfituesit. Konsulenti Zbatues do të kryejë prokurimet në përputhje me planin e prokurimit të rënë dakord dhe me procedurat e veta dhe legjislacionin kombëtar të prokurimit në Suedi. Plani i prokurimit do të përfshijë detaje për çdo prokurim, duke përfshirë procedurat e dakordësuara për konsultime me Përfituesin.

9.2 Përfituesi do të sigurojë përfaqësues në Komitetin e Vlerësimit të tenderit që do të zhvillohet nga Suedia për prokurimin e Konsulentit Zbatues të Programit (SCPA 3).

## 10. Monitorimi

10.1 Përfituesi është përgjegjës për monitorimin e progresit dhe performancës së Programit dhe arritjen e rezultateve të pritshme të tij.

10.2 Suedia do të monitorojë përputhshmërinë dhe performancën bazuar në këtë Marrëveshje.

10.3 Procesi i vlerësimit të ecurisë së zbatimit të Programit do të përshtatet me procesin e rishikimit të Përfituesit dhe do të bëhet kryesisht përmes mbledhjeve të Komitetit Drejtues të Programit që do të mbahen dy herë në vit në lidhje me raportimin e progresit (narrativ dhe financiar).

10.4 Përfituesi dhe Suedia do të mbajnë një dialog të ngushtë në lidhje me mbështetjen dhe zbatimin e Programit.

## 11. Takimet vjetore

11.1 Palët do të takohen çdo gjashtë muaj për të diskutuar zbatimin e Programit. Mbledhjet thirren dhe drejtohen nga Përfituesi nëpërmjet Policisë së Shtetit shqiptar. Takimi i Komitetit Drejtues të Programit do të shërbejë si takimi kryesor ndërmjet palëve. Çdo takim shtesë i nevojshëm për të diskutuar çështje të veçanta mund të organizohet me iniciativën e njërës prej palëve.

11.2 Misionet dhe takimet do të planifikohen në mënyrë që procesi i buxhetit të Programit të lehtësohet dhe që nevoja për kontribut në dialogun e politikave dhe proceset e vendimmarjes, të akomodohen aq sa është e mundur.

11.3 Kostoja e takimeve do të mbulohet nga buxheti i Programit.

11.4 Temat kryesore që do të diskutohen gjatë konsultimeve, përfshijnë ecurinë e zbatimit të Programit, zhvillimin e lidhur me kontekstin politik dhe ekonomik të Programit, devijimet nga plani dhe



arsyet, si edhe masat zbutëse, bashkëpunimin me programet e tjera të asistencës ndërkombëtare, komunikimin ndërmjet palëve të bashkëpunimit programor, evente vjetore për komunikim me palët e jashtme dhe publikun etj.

11.5 Rezultatet e takimit do të regjistrohen në procesverbalin e dakordësuar. Procesverbali i rënë dakord do të hartohet nga Konsulenti Zbatues dhe një draft do t'i dorëzohet Suedisë për miratim dhe komente, brenda dy javëve pas takimit. Suedia do të informojë Përfituesin për miratimin dhe komentet e saj brenda 10 ditëve nga marrja e draftit.

11.6 Mbledhje shtesë konsultative mund të kërkojen nga Përfituesi ose Suedia për çdo temë që lidhet me zbatimin e Projektit/Programit.

## 12. Vlerësimet

12.1 Nëse njëra Palë kryen ose porosit një vlerësim gjatë Programit, ajo duhet të informojë Palën tjetër paraprakisht dhe t'i sigurojë Palës tjetër një kopje të raportit të vlerësimit. Suedia mund të kryejë një rishikim afatmesëm të Programit, nëse është e nevojshme.

12.2 Nëse Suedia kryen një mision vlerësimi ose monitorimi, Përfituesi do të marrë përsipër të ofrojë çdo dokument ose informacion që do të ndihmojë në misionin e vlerësimit ose monitorimit dhe t'i japë të drejtat e aksesit, siç përshkruhet në këtë Marrëveshje.

12.3 Kostoja e një vlerësimi të kërkuar ose të porositur nga Suedia, do të mbulohet nga Suedia.

## 13. Auditimet

E pazbatueshme.

## 14. Shlyerja e interesit, fitimet nga këmbimi dhe fondet e përdorura

E pazbatueshme.

## 15. Korrupsioni dhe parregullsia të tjera

15.1 Palët do të punojnë në mënyrë aktive për të parandaluar korrupsionin dhe parregullsitë e tjera brenda Programit. Ky detyrim zbatohet për të gjithë anëtarët e stafit, konsulentët dhe personelin tjetër jo staf.

15.2 Korrupsioni dhe parregullsia të tjera i referohen të gjitha llojeve të:

a) korrupsionit, duke përfshirë ryshfetin, nepotizmin, shpërblime të paligjshme ose forma të tjera të shpërdorimit të besimit, pushtetit dhe pozitës për përfitime të parregullta;

b) shpërdorimit të parave të gatshme, inventarit dhe të gjitha llojeve të aseteve;

c) deklaratave mashtruese financiare dhe jofinanciare;

d) çdo përdorimi tjetër të fondeve që nuk është në përputhje me planin e punës dhe me buxhetin.

15.3 Palët do të:

a) marrin parasysh rrezikun e korrupsionit dhe parregullsitë e tjera gjatë planifikimit dhe zbatimit të Programit dhe të identifikojnë rreziqet kryesore dhe masat për uljen e rrezikut. Nëse identifikohet një rrezik i konsiderueshëm i korrupsionit dhe i parregullsive të tjera, do të miratohen masa për uljen e rrezikut të identifikuar;

b) organizojnë funksionimin e tyre dhe sistemet e kontrollit të brendshëm, në mënyrë që korrupsioni dhe parregullsitë e tjera të parandalohen, menaxhohen dhe zbulohen;

c) bëjnë përpjekje maksimale për të parandaluar dhe për të ndaluar korrupsionin dhe parregullsitë e tjera brenda Programit; dhe

d) kërkojnë që i gjithë personeli i përfshirë dhe çdo konsulent, furnizues dhe kontraktor i financuar nga Programi të shmangin korrupsionin dhe parregullsitë e tjera.

15.4 Përfituesi do të informojë Suedinë menjëherë për çdo tregues të korrupsionit dhe të parregullsive të tjera në ose në lidhje me Projektin/Programin.

15.5 Përfituesi merr përsipër të hetojë praninë e korrupsionit dhe parregullsitë e tjera dhe të ndërmarrë veprime, duke përfshirë veprimet ligjore, ndaj personave që ka arsye të dyshohen për korrupsion dhe parregullsi të tjera. Palët do të konsultohen vazhdimisht me njëra-tjetrën për trajtimin e mëtejshëm të çështjes.

## 16. Shfrytëzimi seksual, abuzimi seksual dhe ngacmimi seksual

16.1 Palët janë të përkushtuara për të parandaluar dhe reaguar në mënyrë aktive ndaj shfrytëzimit seksual, abuzimit dhe ngacmimit seksual (SEAH), siç përcaktohet më poshtë. Ky detyrim zbatohet për të gjithë anëtarët e stafit, konsulentët dhe personelin tjetër që nuk është pjesë e brendshme e stafit.

16.2 Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “Shfrytëzimi seksual”, çdo abuzim aktual ose i synuar i një pozite vulnerabiliteti ose pozite pushteti, varësie ose besimi, për qëllime seksuale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në përfitimin monetar, social ose politik nga shfrytëzimi seksual i një tjetri.



b) “Abuzimi seksual”, ndërhyrja fizike aktuale ose e kërcënuar e një natyre seksuale, qoftë me forcë ose në kushte të pabarabarta ose shtrënguese.

c) “Ngacmimi seksual”, çdo formë e sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale ose fizike të natyrës seksuale, me qëllim ose efekt shkeljen e dinjitetit të një personi.

16.3 Palët do të marrin parasysh rrezikun e SEAH-së, kur planifikojnë dhe zbatojnë Programin dhe identifikojnë rreziqet kryesore dhe masat për uljen e rrezikut.

16.4 Përfituesi do të informojë menjëherë Suedinë për çdo tregues të SEAH-së në ose në lidhje me Projektin/Programin.

16.5 Përfituesi merr përsipër të hetojë praninë e SEAH-s dhe të ndërmarrë veprime, përfshirë veprimet ligjore, kundër personave për të cilët ka arsye të dyshohet për SEAH-në.

### 17. Rregullimet ligjore

17.1 Në rast mospërputhjeje nga ana e Përfituesit me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, Suedia rezervon të drejtën për të ushtruar mjetet juridike të mëposhtme, duke përfshirë mbajtjen në burim të disbursimeve të mëtejshme dhe/ose reduktimin e disbursimeve të reja, kërkimin e shlyerjes së fondeve ose përfundimin e mbështetjes së saj për Programin.

17.2 Në rast të shkeljes së Marrëveshjes, Suedia mund ta ndërpresë Marrëveshjen me njoftim dy muaj përpara.

17.3 Në rast të shkeljes së rëndë të Marrëveshjes, Suedia mund ta ndërpresë Marrëveshjen me efekt të menjëhershëm.

17.4 Në rastet e përfundimit nga Suedia, përfundimi nuk do të zbatohet për fondet e dedikuara në mënyrë të pakthyeshme në mirëbesim nga Përfituesi ndaj palëve të treta përpara datës së njoftimit të përfundimit, me kusht që angazhimet të jenë bërë në përputhje me këtë Marrëveshje.

17.5 Çdo ndërprerje do të bëhet me njoftim me shkrim për përfundimin.

### 18. Vizibiliteti dhe informacioni

18.1 Kur u referohet aktiviteteve, të financuara plotësisht ose pjesërisht në përputhje me këtë Marrëveshje, Përfituesi gjithmonë do të njohë dhe do të bëjë publike që aktivitetet të financohen përmes ndihmës suedeze për zhvillim.

18.2 Logoja tip e Suedisë do të përdoret në prodhimin e materialeve informative dhe në lidhje me aktivitetet informative.

18.3 Prodhimi i materialeve të tilla është plotësisht përgjegjësi e Përfituesit dhe përgjegjësia e përmbajtjes i takon botuesit. “SIDA” ose “Suedia” nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë që mund të perceptohet sikur SIDA ose Suedia të kenë marrë pjesë në prodhim ose të mbështesin ndonjë opinion të paraqitur.

18.4 SIDA dhe departamentet e tjera të administratës suedeze jashtë vendit rezervojnë të drejtën për të kopjuar dhe shpërndarë materiale të tilla, nëse kërkohet.

### 19. Referimi në marrëveshje të tjera

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve, sipas kësaj Marrëveshjeje, rregullohet gjithashtu nga:

- Marrëveshja mbi Termat dhe Kushtet e Përgjithshme për Bashkëpunimin Zhvillimor ndërmjet Palëve për periudhën nga data 30 qershor 2006 deri në njoftimin e përfundimit nga njëra nga palët;

- çdo marrëveshje që mund të zëvendësojë ose ndryshojë marrëveshjet në fjalë.

### 20. Përfundimi

20.1 Kjo Marrëveshje do të mbetet e vlefshme nëse nuk përfundon paraprakisht me njoftim me shkrim gjashtë muaj përpara nga secila palë.

### 21. Periudha e vlefshmërisë së marrëveshjes

21.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin palët njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave ligjore të parashikuara në legjislacionin e tyre kombëtar për hyrjen në fuqi dhe do të mbetet e vlefshme deri më 31 dhjetor 2029, përveç nëse ndërpritet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, ose deri në kthimin e çdo fondi të papërdorur në Suedi dhe përmbushjen e kërkesave për raportimin, në lidhje me këtë Marrëveshjeje, kohë në të cilën kjo Marrëveshje skadon.

21.2 Përfundimi ose skadimi i Marrëveshjes nuk i çliron Palët nga asnjë përgjegjësi që rrjedh nga ndonjë veprim ose mosveprim që ka ndodhur përpara përfundimit ose skadimit të tillë.

### 22. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Nëse lind ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet Palëve, në lidhje me interpretimin, aplikimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, ato do të konsultohen me njëra-tjetrën për të arritur një zgjidhje me mirëkuptim.



### 23. Njoftime

Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jetë me shkrim, duke specifikuar numrin e kontributit dhe titullin e Programit dhe të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Përfutuesin: Daniela Çekani,  
[daniela.cekani@mb.gov.al](mailto:daniela.cekani@mb.gov.al)

Drejtores e Drejtorisë së Projekteve në Ministrinë e Brendshme

Për Suedinë

Linda Gjermani, [linda.gjermani@gov.se](mailto:linda.gjermani@gov.se)

Në vëmendje të Seksionit për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Zyrtare e Programit Linda Gjermani,  
[linda.gjermani@gov.se](mailto:linda.gjermani@gov.se)

Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, SIDA/Ambasada e Suedisë në Tiranë.

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në gjuhën angleze në dy origjinale, një për secilën palë.

| Vendi dhe data                                                                                  | Vendi dhe data                                                                           |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------|
| Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Brendshme | Suedi, përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) |
|                                                                                                 | Erik Illes, Këshilltar, Përgjegjës i Seksionit për Bashkëpunimin për Zhvillim            |

### PROPOZIMI PËR PROGRAMIN:

#### FAZA E TRETË

### FUQIZIMI I POLICIMIT NË KOMUNITET NË SHQIPËRI

#### Hyrje

Qysh nga viti 2012, Suedia po e mbështet Ministrinë shqiptare të Punëve të Brendshme dhe Policinë e Shtetit të fuqizojnë policimin e tyre në komunitet nëpërmjet dy fazave të një Programi. Faza e dytë e Programit për Fuqizimin e Policimit në Komunitet në Shqipëri (FPKS) përfundoi në fund të vitit 2022. Ministria e Punëve të Brendshme i ka kërkuar Suedisë të vazhdojë mbështetjen dhe ta konsolidojë atë, duke u mbështetur në suksesin e fazave të mëparshme. DCAF ISSAT-i ka punuar me aktorët kryesorë shqiptarë për të kuptuar gjendjen e tashme të zbatimit të koncepteve të policimit në komunitet, përditësuar Projektin e Programit dhe për t'ia përshtatur kontekstit të tashëm dhe për të identifikuar qasjen e duhur për zgjatjen. Procesi i

hartimit për Fazën e Tretë vlerësoi informacionin, në lidhje me gjendjen e tashme të reformave brenda të tri shtyllave, identifikoi dhe vleftësoi nevojat dhe prioritetet e partnerëve të ndryshëm të Projektit, në lidhje me këto fusha të zbatimit, dhe nga kjo analizë paraqiti dokumentin për propozimin e Projektit për të orientuar ekipin zbatues të Fazës së Tretë.

Propozimi i paraqitur është i organizuar sipas të tria shtyllave të njëjta të përdorura gjatë Fazës së Dytë, pasi vizita vlerësuese pa me vend rëndësinë dhe nevojën në vijim për mbështetje nga Programi në të gjitha këto drejtime. Secili seksion identifikon aspektet kryesore të zbatimit të Programit që janë komponentë të nevojshëm të Fazës së Tretë, pa të cilat Programi nuk mund të jetë i suksesshëm në mbështetjen e përmirësimeve të qëndrueshme. Këto tri shtylla janë: 1. përmirësimi i efektivitetit të zbatimit të policimit në komunitet; 2. fuqizimi i përgjegjshmërisë dhe bashkërendimit polici-shtet, së bashku me aftësinë analitike të policimit në komunitet; 3. përmirësimi i reagimeve policore ndaj prioritetëve komunitarë, duke përfshirë dhunën në familje. Siç ishte rasti me fazat e mëparshme, Programi do të ketë një komponent mbisektorial të grandeve të vogla, që do të përdoren për të përforcuar pjesëmarrjen dhe ndikimin e komunitetit mbi zhvillimin e qasjeve të policimit në komunitet.

Qëllimi i këtij dokumenti është ofrimi i një përshkrimi të hollësishëm të konceptit, strukturës dhe aktiviteteve kryesore të Programit në Fazën e Tretë të FPKS-së. Ky është rezultat i një procesi konsultimesh të zhvilluara me aktorët kryesorë, duke përfshirë Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Policinë Shqiptare të Shtetit (PSS), Qeverinë e Shqipërisë (QS) dhe aktorët komunitarë shqiptarë, që kanë rënë dakord për drejtimet dhe sferat e punës. Ky dokument është hartuar për t'i ofruar Agjencisë Suedeze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillimin (SIDA) një bazë për shpalljen e tenderit për të formuar ekipin e Programit për menaxhimin e fazës së tretë të zbatimit.

Përmbajtja

#### Hyrje

#### Shkurtime

Konteksti i Reformës në Polici

Kontributi Reformues i Fazave të Mëparshme

Propozimi për Programin

Vizioni dhe Teoria e Ndryshimit

Përmirësimet në Policimin në Komunitet



Analiza dhe Përgjegjshmëria e Policimit në Komunitet

Kapacitet i Specializuar i Policisë për Prioritetet Komunitare

Skema e grandeve

**Bashkëpunimi me Partnerët Ndërkombëtarë**

Gjinia dhe të drejtat e njeriut

Profili dhe shtrirja e Programit

Projektbuxheti

Menaxhimi i Programit dhe qeverisja

Faza tranzitore dhe mbyllja e Programit

Risku

Përfundim

**Aneksi A**

Kuadri monitorues dhe udhëzuesi i treguesve

**ANEKSI B**

Matrica e menaxhimit të riskut

**ANEKSI C**

Lista e intervistave dhe vizitat e zhvilluara

**ANEKSI D**

Projektbuxheti në euro

### Shkurtime

|            |                                                                                                                    |
|------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| AKSHI      | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit                                                                    |
| PSS        | Policia e Shtetit Shqiptar                                                                                         |
| KVT        | Kamera të vendosura në trup                                                                                        |
| OSC        | Organizata të shoqërisë civile                                                                                     |
| DCAF ISSAT | Ekipi Këshillimor i Sektorit Ndërkombëtar të Sigurisë të Qendrës së Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë |
| EU4LEA     | Bashkimi Evropian për Zbatimin e Ligjit në Shqipëri                                                                |
| QSH        | Qeveria e Shqipërisë                                                                                               |
| INSTAT     | Instituti i Statistikave                                                                                           |
| KLSP       | Këshillat Lokale të Sigurisë Publike                                                                               |
| RLP        | Rreth Lokal i Policisë                                                                                             |
| SMSL       | Sistemi i Matjes së Sigurisë Lokale                                                                                |
| MAS        | Ministria e Arsimit dhe Sporteve                                                                                   |
| MSMS       | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale                                                                     |
| MB         | Ministria e Punëve të Brendshme                                                                                    |
| RAM        | Rishikim Afatmesëm                                                                                                 |
| OSBE       | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë                                                                    |
| EMP        | Ekipi i Menaxhimit të Projektit                                                                                    |
| KDP        | Komiteti Drejtues i Projektit                                                                                      |
| SAM        | Sektori i Analizës dhe Monitorimit                                                                                 |
| ASPSKN     | Agjencia Shtetërore për Programet Strategjike dhe Koordinimin e Ndihmës                                            |
| FPKS       | Programi i Fuqizimit të Policimit në Komunitet në Shqipëri                                                         |
| OSS        | Oficeri i Sigurisë në Shkollë                                                                                      |
| SIDA       | Agjencia e Bashkëpunimit Suedez Ndërkombëtar për Zhvillim                                                          |
| MB         | Mbretëria e Bashkuar                                                                                               |
| PZKB       | Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara                                                                      |

### Konteksti i reformës në polici

Programi FPKS-ë përfiton nga një marrëdhënie e mirëvendosur ndërmjet aktorëve kryesorë të ministrisë dhe policisë, dhe nga një historik i provuar i mbështetjes së vazhdueshme. Si rrjedhim, ky gëzon një nivel të konsiderueshëm mbështetjeje nga drejtuesit e lartë të policisë dhe vlerësohet dhe njihet në të gjitha drejtoritë. Ka kufizime në masën në të cilën kuptohen qëllimi dhe detajet e disa përpjekjeve për reforma përtej vendndodhjeve të pilotimit, të cilat përfituan pjesën më të madhe të mbështetjes së Programit në Fazën e Dytë.

Procesi i projektimit po kryhet ndërkohë që edhe drejtori i përgjithshëm po planifikon të ristrukturojë forcën e policisë. Ky ristrukturim do të rezultojë në transferimin e një numri të konsiderueshëm të personelit të Policimit në Komunitet në ekipet e Hetimit të Krimit, krijimin e ekipeve të vogla të punonjësve të policimit në komunitet të fokusuar në ndërgjegjësimin në shkollë, si dhe në forcimin e modelit të policimit të zonës. Rezultati i këtyre ndryshimeve është refuzimi i një përqasjeje ndaj policimit në komunitet që fokusohet në modele të qarta dhe të veçanta të oficerëve të policimit në komunitet/të zbatimit të ligjit. Ai ka potencialin e zgjerimit të objektit të fokusuar në komunitet të një gamë më të gjerë oficerësh, por rrezikon të humbasë vëmendjen e fokusit në komunitet nëpërmjet ndryshimeve të projektuara për të forcuar aftësinë hetuese.

Kufizimet e menaxhimit aktual të burimeve njerëzore të policisë kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në udhëheqjen dhe menaxhimin e policisë. Shembulli më i qartë i kësaj mund të shihet në qasjet aktuale ndaj transferimit në nivelin e menaxhimit policor, që ndodhin shumë shpesh dhe nuk u japin menaxherëve kohë të mjaftueshme për të zhvilluar seksionet e tyre, rezultojnë në ndërprerje të konsiderueshme të proceseve të planifikimit dhe reformës dhe nuk janë në përputhje me ligjin aktual në lidhje me transferimin e personelit. Megjithatë, me gjithë ndikimin e konsiderueshëm të kësaj çështjeje në përmirësimet në policimin në komunitet, ka vullnet të kufizuar për ta trajtuar këtë çështje dhe realizimi i kësaj do të kërkonte një Program të përkushtuar mbështetjeje për reformën e menaxhimit të burimeve njerëzore brenda PSS-së.

### Kontributi reformues i fazave të mëparshme

Suksesi i fazave të mëparshme të Programit FPKS-ë tregon se një filozofi e policimit në



komunitet kuptohet nga PSS-ja në të gjithë Shqipërinë dhe se një numër i konsiderueshëm oficerësh janë trajnuar për këto qasje. Zbatimi i policimit në komunitet është më i plotë në zonat që kanë marrë mbështetjen më të madhe të Programit dhe garantohet një mbështetje më e gjerë për të siguruar qëndrueshmëri të qasjes në të gjithë Shqipërinë. Shqetësimi në lidhje me korrupsionin e policisë mbetet i lartë dhe tendenca e fundit në besimin e komunitetit është e përzier, megjithëse kjo është në një kontekst të shqetësimeve përgjithësisht të larta të korrupsionit në të gjitha shërbimet qeveritare. Si e tillë, mbështetja në Fazën e Tretë të Programit duhet të trajtojë si qëndrueshmërinë e efektivitetit të qasjeve në qendër të komunitetit, ashtu edhe të mbështesë përpjekjet e orientuara nga brenda për të forcuar transparencën dhe përgjegjshmërinë e PSS-së ndaj komunitetit të cilit i shërbejnë.

Përpjekjet menaxheriale janë fokusuar në zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet policisë dhe autoriteteve vendore, që është një mekanizëm i arsyeshëm. Kjo aktualisht është zbatuar vetëm pjesërisht dhe ka një nivel të lartë të ndryshueshmërisë në nivelin e efektivitetit të Këshillave Lokale për Sigurinë Publike (KLSP). Si rezultat, duhet bërë shumë më tepër për të integruar komitetet në mënyrë të qëndrueshme dhe për të siguruar që roli dhe kompetencat e tyre të kuptohen mirë dhe të jenë të qëndrueshme në të gjitha qarqet. Mbështetja e Programit për policimin e orientuar nga të dhënat gjithashtu ka përparuar shumë, por është qartësisht më e avancuara në fushat e programeve pilot. Është bërë shumë më pak për menaxhimin e përgjithshëm të policisë, dhe duke pasur parasysh shtrirjen e çështjeve rreth Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, veçanërisht në nivelin drejtues dhe kjo ka shumë të ngjarë të mbetet jashtë objektit të fazës së tretë.

Për sa u përket kapaciteteve të specializuara policore për të adresuar çështjet e komunitetit, Programi ka mbështetur dukshëm përmirësimet në reagimin e policisë ndaj dhunës në familje, policimin e qarkullimit rrugor dhe mbrojtjen e të rinjve nëpërmjet programeve të ndërgjegjësimit të shkollave. Të tri fushat mbeten të rëndësishme për

angazhimin e komunitetit dhe përmirësimet që janë arritur kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme për të siguruar që ato të jenë njëtrajtshmërisht efektive dhe të qëndrueshme.

### **Propozimi për Programin**

#### **Vizioni dhe teoria e ndryshimit**

Qëllimi i Programit mbetet i njëjtë me atë të fazës së mëparshme:

Besimi dhe partneriteti i përmirësuar ndërmjet policisë dhe komunitetit i bën lagjet më të sigurta.

Kjo do të arrihet përmes një plani pesëvjeçar të mbështetjes që do të përfshihet në tri fusha kryesore të asistencës. Shtylla e parë fokusohet në konsolidimin dhe zgjerimin e përshtatjes së policimit në komunitet nga PSS-ja si një qasje. Shtylla e dytë vazhdon të zhvillojë një qasje të bazuar në të dhënat për policimin në komunitet në të gjithë PSS-në, ndërkohë që forcon lidhjet midis pjesëve të qeverisë me objekt garantimin e sigurisë publike. Duke bërë këtë, sigurohet që PSS-ja merr vendime mbi bazën e një kuptimi të qartë të prioritetëve të komunitetit dhe është në gjendje të shfrytëzojë të gjithë gamën e kapaciteteve të qeverisë në mbështetje të përmirësimit të sigurisë për komunitetin. Shtylla e fundit fokusohet në sigurimin që PSS-ja të ketë kapacitete adekuate në temat kyçe të policimit të posaçëm, në lidhje me dhunën në familje, qarkullimin rrugor dhe angazhimin e të rinjve. Kjo shtyllë siguron që reagimet e PSS-së ndaj prioritetëve të komunitetit të jenë të përshtatshme dhe të bazuara në një kuptim të qartë të çështjeve, nevojave të grupeve vulnerabël dhe që policia të ketë aftësitë e duhura për të reaguar në mënyrë adekuate.

#### **Përmirësimet në Policimin në Komunitet**

Fokusi kryesor i Programit të Fazës së Tretë do të vazhdojë të jetë miratimi dhe zbatimi i suksesshëm i parimeve dhe i praktikave të policisë me fokus komunitetin. Kjo do të përfshijë menaxhimin e çdo procesi të ndryshimit strukturor të PSS-së për të garantuar ruajtjen e përfitimeve në qasjet e policimit në komunitet, përmirësimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të policimit në komunitet në të gjithë vendin, trajnimin e mëtejshëm të personelit në parimet e policimit në komunitet dhe përmirësimin e llogaridhënies së oficerëve në kontakt me Komuniteti.



| Policia zbaton në mënyrë efektive qasjet e fokusuara në komunitet               |                                                   |                                               |
|---------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|-----------------------------------------------|
| Oficerët angazhohen me komunitetet                                              |                                                   | Menaxhimi mbështet fokusimin në komunitet     |
| Trajnim për Policimin në Komunitet                                              | Përgjegjshmëria (kamerat e trupit dhe monitorimi) | Integrimi i qasjeve të fokusuara në komunitet |
| Zbatimi i policimit të fokusuar në komunitet i mbështetur në më shumë drejtori. |                                                   |                                               |

### Oficerët e trajnuar në mënyrë të përshtatshme

Nevoja për të trajnuar oficerët e komunitetit të sapoemëruar ose shtesë do të jetë një domosdoshmëri e vazhdueshme, megjithëse duket se PSS-ja është pothuaj në gjendje ta kryejë këtë në mungesë të mbështetjes së mëtejshme programore. Pas mbi dhjetë vjet programimi të FPKS-së, parashikohet që të ketë një masë të mjaftueshme oficerësh të trajnuar në komunitet për të kryer trajnime dhe mentorim për oficerët e sapoemëruar, dhe se konceptet janë integruar në trajnimin bazë të të gjithë policëve të rinj që hyjnë në shërbim. Kjo nuk ka pasur përparimin e shpresuar, për shkak të një numri çështjesh në nivelin e Akademisë së Policisë. Në këtë moment Akademia ka mbështetjen e disa donatorëve të tjerë dhe nuk duhet të jetë në qendër të mbështetjes nga Programi, megjithatë, Programi e ka të nevojshme të monitorojë masën në të cilën Akademia integron me sukses konceptet e policimit në komunitet në kurrikulën e saj të trajnimit.

Ndryshimet e propozuara në strukturën e policimit në komunitet, ku oficerët e komunitetit vendor kanë një përgjegjësi të shtuar për hetimet penale të nivelit parësor dhe në disa raste detyra të tjera të zbatimit, ka të ngjarë të ekspozojnë një boshllëk aftësish dhe nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Ky do të jetë veçanërisht rasti për ata oficerë të komunitetit që kanë qenë në detyrë për shumë vjet dhe nuk kanë ushtruar përgjegjësi më të gjera policore. Një nga disavantazhet e përcaktimit të përgjegjësiave të policisë së komunitetit nga kërkesat më të gjera të policisë është se aftësitë ekzistuese mund të humbasin ose aftësitë e reja të mos mësohen.

Kur të zbatohen, ndryshimet e propozuara do të zgjerojnë përgjegjësitë policore të oficerëve të komunitetit pa i dobësuar ato. Duhet pasur kujdes që të mos pakësohen aktivitetet aktuale të edukimit dhe parandalimit të kryera në shkolla dhe gjetkë. Në përgjithësi, avantazhet e fituara në pasjen e një elementi më fleksibël, më reagues dhe të integruar të policimit në komunitet shpresojmë të tejkalojnë çdo

disavantazh të perceptuar. Megjithatë, ndryshimet e propozuara rishtazi do të funksionojnë në mënyrë të kënaqshme vetëm nëse të përfshirët marrin trajnimin e duhur për rolin e tyre të rishikuar në polici. Një trajnim i tillë duhet të jetë në fokus të Programit të Fazës së Tretë dhe të plotësohet nga iniciativë për rritjen e aftësive të kryera nga PSS-ja.

Fushat e mundshme të trajnimit, të cilat mund të mos identifikohen plotësisht derisa të miratohet dhe zbatohet Programi i ndryshimit të PSS-së, mund të përfshijnë:

- I. Sigurimi i vendeve të krimit dhe mbledhja e provave;
- II. Marrja e deklaratave;
- III. Aftësitë bazë të intervistës;
- IV. Aftësitë për zgjidhjen e konflikteve; dhe
- V. Plotësimi i dosjeve të çështjeve.

### Përgjegjshmëria e Zbatimit të Policimit në Komunitet

Linja e dytë e mbështetjes për policimin në komunitet është përmirësimi i përgjegjshmërisë së policisë në ofrimin e një shërbimi të fokusuar në komunitet. Janë dy aktivitetet kryesore që do të zhvillohen në këtë linjë mbështetjeje: Së pari, ruajtja e sistemit të shoqërimit dhe monitorimit nga ekspertët e Programit të policimit që ishte një sukses i madh i fazës së dytë dhe, së dyti, vlerësimi organizativ dhe një sistem i mundshëm pilot i Kamerave të Vendosura në Trup (KVT) për të mundësuar një rishikim më të hollësishëm të veprimeve të policisë kur janë në kontakt me komunitetin.

#### Mbështetja për monitorimin e Programit

Për sa i përket monitorimit, përpjekja kryesore në Fazën e Tretë do të jetë vazhdimi i vizitave të rregullta nga eksperti ndërkombëtare i policimit dhe stafi tjetër i Programit që ka qenë një model kaq efektiv i mbështetjes në Fazën e Dytë. Vizitat të fokusohen në ndjekjen e trajnimeve, angazhimin dhe zgjidhjen e problemeve me drejtuesit e lartë në nivel drejtorie apo komisarati, për mënyrën se si po vijon zbatimi, si dhe angazhimin në ecurinë e elementeve të ndryshme të mbështetjes së programeve. Kjo përfshin vazhdimin e punës sipas





shtyllave të tjera, siç është mbështetja për përmirësimin e qëndrueshmërisë së funksionimit të Sektorëve për Analizë dhe Monitorim (SAM) dhe funksionimin e KLSP-ve përkatëse. Rregullsia dhe diapazoni i qëllimit të këtyre vizitave funksionon për të zhvilluar marrëdhëniet ndërmjet stafit të Programit dhe strukturave të policisë dhe mbështet vëmendjen e vazhdueshme për ecurinë e reformave.

Një sasi e konsiderueshme e kohës së Programit investohet në mekanizma të tillë monitorues, megjithatë ato përfaqësojnë një mekanizëm kritik me të cilin faza e tretë mund të sigurojë që ajo të mbetet e vetëdijshme për progresin në zbatimin e qasjeve të policimit në komunitet, ndikimin e ristrukturimit në policimin në komunitet, dhe identifikojnë çështjet e komunitetit dhe krimin në nivel drejtorie/komisariati që mund të kërkojnë asistencë programore.

#### **Vlerësimi i kamerave të vendosura në trup**

Është e qartë se MPB-ja dhe PSS-ja shohin avantazhe nëse oficerët pajisen me një teknologjinë KVT, për arsye të rritjes së përgjegjshmërisë së policisë, intensifikimit të mbledhjes së provave dhe mbrojtjes së punonjësve nga ankesat e pajustificuara ose shqetësuese. Përvoja ndërkombëtare ka treguar se kuadri i politikave që mbështet prezantimin dhe përdorimin operacional të KVT-ve është kompleks dhe i ndërlikuar, me masa mbrojtëse ligjore thelbësore të cilat duhen trajtuar. Për më tepër, ekziston çështja se ku ose si të kryhet studimi pilot, p.sh. sipas vendndodhjes gjeografike, përcaktimit të njësisë ose zonës së ndjeshmërisë së policisë ose shqetësimit publik.

Nëse MPB-ja dhe PSS-ja vendosin të kryejnë një sistem pilot me kamera trupi, Programi mund të mbështesë në mënyrë të dobishme hartimin dhe zbatimin e një kuadri/udhëzuesish të politikave dhe operacionale përkatëse. Theksohet se kjo është një fushë veprimi politike komplekse dhe shpesh e kontestuar, dhe këshillat ligjore dhe gjykimet do të jenë një faktor kritik për t'u marrë parasysh.

Në përputhje me udhëzimet e prokurimit të FPKS-së, Programi mund të dëshirojë, gjithashtu, të financojë blerjen e një numri të kufizuar kamerash dhe pajisjeve të lidhura, p.sh. njësitë e kompresimit dhe t'ruajtjes së videos, sistemet e monitorimit, sistemues dhe të karikimit etj., si përdorim në provë. Megjithatë, një mbështetje e tillë e kufizuar logjistike duhet të konsiderohet vetëm në konsultim dhe

brenda fushës së përgjegjësisë së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Duhet theksuar se mbështetja nga Programi me mjete logjistike dhe pajisje do të kufizohet në çdo studim pilot të drejtuar nga MB/PSSH-ja dhe të kryhet me rezervën e miratimit nga AKSHI, sipas rastit. Zbatimi i plotë i sistemit, nëse pilotimi do të jetë i suksesshëm në zhvillimin e një qasjeje koherente dhe efektive, do të jetë përgjegjësi e Qeverisë Shqiptare.

#### **Mbështetja e Nivelit Drejtues të Policisë për të Integruar Qasjet e Policimit në Komunitet**

Përveç rritjes ose ofrimit të aftësive të reja për oficerët e policimit në komunitet, ekziston nevoja për të përforcuar më tej konceptet dhe avantazhet e grumbulluara të filozofisë dhe të praktikës së policimit në komunitet me disa oficerë të lartë të PSS-së. Ndërsa pranohet se parimet e policimit në komunitet janë miratuar lehtësisht nga shumë oficerë individualë, veçanërisht në zonat pilot të Fazës Një dhe Dy, ekzistojnë prova që sugjerojnë se jo të gjithë oficerët e lartë i kanë integruar plotësisht qasjet në menaxhimin e zonës së tyre të policimit. Vetëm trajnimi nuk do ta korrigojë këtë situatë dhe një aspekt kyç i fazës së tretë të programit do të jetë adresimi i qëndrueshmërisë së zbatimit përmes formave të shumta të mbështetjes. Kjo mund të përfshijë inkurajimin nëpërmjet vizitave monitoruese dhe mentoruese, së bashku me organizimin e seminareve/*workshop*-eve në Shqipëri, me pjesëmarrës nga brenda dhe jashtë shërbimit policor, ashtu dhe me kontribute ndërkombëtare për të diskutuar më tej avantazhet e policimit në komunitet.

#### **Analiza dhe përgjegjshmëria e policimit në komunitet**

Faza e tretë e Programit do të angazhohet veçanërisht në mbështetje të integritetit të policisë në sistemin në zhvillim të këshillave bashkiakë të sigurisë, si një qasje për koordinimin e shërbimeve shtetërore që është testuar me sukses nga MPB-ja shqiptare gjatë Fazës së Dytë. Përpjekja tjetër madhore është nevoja për të mbështetur përmirësimet në përdorimin e të dhënave nga PSS-ja, duke përfshirë konkretisht SAM-et, të cilët janë të pranishëm në të gjitha Drejtoritë e PSS-së, por që jashtë vendndodhjeve pilot nuk kanë përfituar të gjithë mbështetje të mjaftueshme nga Programi.



| Policia është e integruar mirë në këshillat për sigurinë e komuniteteve bashkiake |                                                                                                    |                                      |
|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------|
| KLSP-të funksionojnë në mënyrë efektive për të mbështetur sigurinë e komunitetit  | PSS-ja i përdor në mënyrë efektive të dhënat për të menaxhuar prioritetet e policimit në komunitet |                                      |
| Mbështet funksionimin e KLSP-ve                                                   | Pilotimi i një sistemi më të mirë për menaxhimin e të dhënave të komunitetit                       | Përmirësime në mbështetjen e SAM-eve |
| OSC-të marrin pjesë dhe ndikojnë mbi PSS-në dhe KLSP-të                           |                                                                                                    |                                      |

### Këshillat lokalë të sigurisë publike

Fuqizimi i partneriteteve dhe i besimit reciprok ndërmjet policisë dhe aktorëve lokalë është rezultati kryesor i këtij Programi. Për të fuqizuar qasjet e partneritetit, në vitin 2016 u ngritën Këshillat Lokalë të Sigurisë Publike (KLSP). Kjo ishte një nismë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, e mbështetur nga Programi dhe më pas e pilotuar dhe e shtrirë në shumicën e bashkive gjatë nëntë muajve në vijim. Deri më sot, 56 nga 61 bashkitë thuhet se kanë krijuar komitete të sigurisë publike (vizitat në terren sugjerojnë se ky është një vlerësim tepër optimist, p.sh. në qarkun e Elbasanit u tha se vetëm një nga shtatë KLSP-të funksiononte mjaftueshëm shpesh për të qenë efektiv). Numri i KLSP-ve të krijuara dhe plotësisht efektive është ndoshta shumë i vogël dhe një rishikim për të vërtetuar ekzistencën dhe qëndrueshmërinë aktuale të këtyre strukturave është i vonuar.

Duhet të theksohet se KLSP-të janë themeluar me rekomandim të MB-së, por në mungesë të kuadrit rregullator ligjor. Kjo është një çështje që duhet të trajtohet nga MB-ja në të ardhmen, mundësisht me mbështetjen e Programit, nëse kjo asistencë konsiderohet e përshtatshme.

Për të ruajtur përfitimet e arritura tashmë dhe për të trajtuar ndryshimin aktual në kapacitetin e KLSP-së konkrete, do të jetë thelbësore të sigurohet mbështetje shtesë e vazhdueshme gjatë Fazës së Tretë. Kjo mbështetje duhet të fokusohet në komunitetet më të mëdha bashkiake, ku këshillat mund të përbëhen me përfaqësim adekuat. Kjo mbështetje shtesë duhet të përfshijë trajnime të mëtejshme, vizita mentorimi dhe monitorimi ose qasje të tjera për ngritjen e kapaciteteve, të cilat duhet të ofrohen në mënyrë të koordinuar me agjenci të tjera ndërkombëtare, si p.sh., Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), të cilat deri më sot kanë mbështetur KLSP-në në Shkodër dhe tetë zona të tjera bashkiake.

Duhet të ritheksohet se nuk parashikohet që nga Programi të ofrohet mbështetje për të gjitha KLSP-të, por duhet të hartohet një kriter ndërmjet të gjitha

palëve të interesuara (MB, PSS, kryetarët e bashkive etj.) për të përcaktuar se në cilat vendndodhje do të jetë prioritar kjo mbështetje, për sa kohë dhe në çfarë mënyre – nuk sugjerohet që të përdoret një metodologji e vetme e ofrimit. Çdo rast duhet të trajtohet në bazë të veçantive të tij, duke pasur parasysh karakteristikat lokale politike, kulturore dhe komunitare, si dhe kapacitetin e këtyre grupeve për të përvetësuar dhe për të mbështetur mënyra të reja të punës. Përfshirja aktive e kryetarit përkatës të Bashkisë është e një rëndësie thelbësore, duke pasur parasysh përgjegjësinë e tyre ligjore për drejtimin e strukturave të KLSP-ve.

Programi mund të punojë me Organizatat e Shoqërisë Civile (OSC) nëpërmjet skemës së grandeve të Programit (shih seksionin specifik) për të ofruar udhëzime dhe mbështetje të përshtatshme për strukturat individuale të KLSP-ve, si metoda më efektive për të siguruar një lidhje të fortë midis këtyre këshillave dhe komuniteteve të tyre përkatëse, duke qenë, gjithashtu, një qasje e përfuturit të vlerës së shpenzimeve.

Qëllimi i përcaktuar i KLSP-ve, për të forcuar sigurinë publike si organ këshillues në bashki, dhe përbërja e tij e gjerë dhe përfaqësuese potencialisht e shndërrojnë këtë në një metodë të rëndësishme dhe të besueshme të lidhjes së gamës së plotë të shërbimeve qeveritare me komunitetin. Aktualisht, kudo që KLSP-të konkrete janë aktive, këto janë fokusuar në çështjet që lidhen me sigurinë publike; ato janë, gjithashtu, të autorizuar për të përmirësuar besimin ndërmjet njësive administratës publike (përfshirë PSS-në) dhe grupeve komunitare dhe qytetarëve individualë.

Duhet të theksohet se koncepti i KLSP-ve duhet të fokusohet në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të sigurisë dhe sigurisë së komunitetit lokal, shumë prej të cilave mund të jenë të një natyre të vogël që kërkojnë vetëm kryerjen e veprimeve korrigjuese me kosto të ulët. Plane më ambicioze dhe më të shtrenjta mund të jenë të përshtatshme në disa vendndodhje më të mëdha urbane të KLSP-ve, por roli kryesor i këtyre komuniteteve është të



drejtojnë caktimin e burimeve të tyre në prioritetet kyçe të komunitetit, dhe jo të identifikojnë kërkesat e reja për burime.

Fazat e mëparshme të Programit FPKS nuk janë fokusuar veçanërisht në përmirësimin e llogaridhënies së policisë, megjithëse hartimi dhe dokumentacioni i Programit sugjeron se mund të krijohen raporte midis rritjes së reagimit të policisë, efektivitetit dhe perceptimeve të përmirësuara të publikut. Megjithatë, bazuar në studimin e programeve të zhvillimit të sigurisë publike/policore gjatë në botë, është e qartë se grupet konsultative lokale, si KLSP-ja në Shqipëri, mund të përdoren për të përmirësuar performancën dhe sjelljen e policisë lokale. KLSP-të mund të identifikojë aktivitetet që kërkojnë vëmendjen e policisë dhe të sigurojë një vlerësim të efektivitetit dhe afateve të (ose mos)reagimit të policisë sipas pritshmërive të bashkisë. Një informacion i tillë jo vetëm që do të ndihmonte drejtuesit e policisë lokale në vlerësimin e performancës, por gjithashtu do të lejonte përmirësime afatgjata ose ndryshime në praktikat e policisë duke ofruar një lidhje të drejtpërdrejtë me reagimet e komunitetit dhe bashkisë. Programi do të luajë një rol në mbështetjen e çdo aktiviteti që forcon përgjegjshmërinë e policisë lokale.

Kjo nuk do të thotë që KLSP-të duhet të kërkojnë llogari policisë, duke iu shmangur përgjegjësi të veta. Që KLSP-të të funksionojë në mënyrë efektive, të gjithë partnerët përfaqësues duhet të punojnë në mënyrë të koordinuar dhe konsultative, duke pranuar se të gjitha institucionet/organizatat e tyre kanë një rol për të luajtur në përmirësimin e cilësisë së sigurisë së komunitetit lokal.

Është sugjeruar që strukturat e KLSP-ve do të përfitonin nga mekanizmat shtesë koordinues në nivel shtetëror. Ekzistojnë qartazi avantazhe për një bashkërendim më të mirë nëpërmjet identifikimit lokal të prioritetëve dhe qasjeve për zgjidhjen e problemeve të miratuara në nivel bashkiak, mund të vuajë nëse një zgjerim i koordinimit do të çonte në një drejtim të një niveli më të lartë. Programi do të duhet të angazhohet me MPB-në nëse çështja e koordinimit të nivelit më të lartë të KLSP-ve do të kërkojë një shqyrtim të politikave.

### **Fuqizimi i Sektorëve të Analizës dhe Monitorimit**

Krijimi i SAM-eve ka treguar një ndikim të vërtetë në vendndodhjet pilot dhe ka çuar në

krijimin e ekipeve nga PSS-ja në të gjitha Rrethet Lokale të Policisë (RLP). Miratimi i kësaj strukture ka potencialin për t'i mundësuar PSS-së të zbatojë format e policimit të udhëhequra nga komuniteti dhe të dhënat në mënyrë më strategjike, por është e qartë se suksesi i zbatimit ndryshon në vende të ndryshme, për shkak të kufizimeve në të kuptuarit e qasjes, dallimeve në personel, përshtatshmërisë për rolet e analizës dhe kufijtë e mbështetjes së mundshme të Programit në fazën e dytë. Sektorët janë, gjithashtu, të lidhur dobët për shkak të një aftësie të kufizuar qendrore për të pranuar dhe për të integruar të dhëna të tilla për t'u përdorur nga Selia Qendrore, dhe për shkak të mungesës së prioritizimit të qasjeve të bazuara në të dhëna.

Faza e Tretë do të fokusohet në zgjerimin e mbështetjes gradualisht nga vendndodhjet e projekteve pilot në të gjitha DLP-të për t'i ndihmuar ato në zbatimin efektiv të konceptit dhe për të siguruar që informacioni të menaxhohet dhe të përdoret në mënyrë adekuate në të gjithë nivelin e organizatës. Në shumë vende kjo mund të përfshijë punën me drejtimin e policisë së DLP-së për t'i sensibilizuar ata për dobinë dhe avantazhet e aftësisë që ata tashmë kanë. Kjo gjithashtu do të përfshijë punën me personelin e sektorit për t'i udhëzuar dhe mbështetur ata që të bëhen analistë efektivë. Së fundmi, ai do të përfshijë punën me Drejtorinë Qendrore për të përmirësuar menaxhimin qendror dhe përdorimin e këtij informacioni, dhe për të inkurajuar një kulturë të pritshmërive rreth cilësisë dhe përdorimit të të dhënave.

Faza e tretë do të duhet të ketë prioritet mentorimin e menaxhmentit të lartë dhe të mesëm për të siguruar që roli specifik i sektorëve në planifikim të kuptohet më mirë. Ishte e qartë se nuk ka një kuptim të qartë se si sektorët ndryshojnë nga seksionet në saje të përdorimit të analizës së kriminalitetit. Duke qenë se strukturat aktuale në Selinë Qendrore nuk i pasqyrojnë ato të sektorëve të RPL-së, duhet t'i kushtohet vëmendje krijimit të një njësie qendrore për integrimin dhe menaxhimin e sektorëve dhe përmirësimin e të kuptuarit, përdorimit dhe caktimit të detyrave të sektorëve të RPL-së.

Një pjesë kyçe e përmirësimit të përdorimit dhe rrjedhës së të dhënave brenda organizatës mund të jetë një pilot i sistemit të futjes së informacionit të bazuar në tablet në ekipet e policisë së komunitetit, i ngjashëm me atë që po përdoret me sukses nga



policia rrugore. Një sistem i tillë do të adresonte disa nga problemet themelore funksionale që pengojnë transferimin e informacionit nga oficerët që e mbledhin atë në një format të dobishëm për të gjithë, që mund të mundësojë vendimmarrje dhe shpërndarje më të mirë të burimeve. Ka dallime domethënëse midis policimit në komunitet dhe qarkullimit rrugor, që do të thotë se nuk është detyrë e lehtë përshtatja dhe zbatimi i një sistemi që mund të kapë në mënyrë të dobishme gamën më të gjerë të formave më komplekse të informacionit që do të duhet të regjistrohen. Është përtej qëllimit të këtij Programi zbatimi i plotë i një sistemi tabletash të policimit në komunitet, por nëse një projekt pilot në një vend të caktuar tregon një ndikim të dukshëm në cilësinë dhe rrjedhën e informacionit, atëherë QSH-ja do të ketë një bazë provash nga e cila mund të gjykojë, në lidhje me investimin e tyre në këtë kapacitet. Ashtu si KVT-të, ky lloj projekti i IT-së duhet të përparojë vetëm me miratimin e AKSHI-t, për të siguruar që ai të jetë i bazuar në planin e përgjithshëm të menaxhimit të IT-së nga Qeveria Shqiptare.

#### Anketat në komunitet

Mbështetja për aftësinë analitike të RLP-ve dhe KLSP-ve do të thotë që Faza e Tretë duhet të vazhdojë më tej me sondazhet në komunitet, të cilat i japin PSS-së dëshmi të qarta të performancës së tyre dhe dinamikës së besimit të komunitetit. Kryerja e vazhdueshme e Anketës vjetore të Perceptimit për Policinë do të sigurojë një masë të nivelit të lartë të suksesit në zhvillimin e besimit të komunitetit. Sistemi Lokal i Matjes së Sigurisë (SLMS) ofron të dhëna edhe më të mira për të orientuar policinë drejt prioriteteve të komunitetit në fusha specifike, por për shkak të kostonë së anketës nuk mund të kryhet

aq gjerësisht sa do të ishte ideale. Pavarësisht këtyre kufizimeve, nuk ka asnjë mënyrë më të lehtë apo më të mirë që Programi të mbështesë mbledhjen e këtyre të dhënave të cilësisë së lartë në nivel vendi/rajonat dhe të vazhdojë t'i mundësojë PSS-së të zhvillohet në një organizatë të orientuar nga të dhënat.

Fazat e mëparshme të Programit u përpoqën të krijonin një model të qëndrueshëm për anketat brenda organizatave partnere të komunitetit, por pa sukses. Vëzhgimet kombëtare ose rajonale të këtij lloji menaxhohen më shpesh nga agjencia kombëtare e statistikave, në rastin e Shqipërisë Instituti i Statistikave (INSTAT). Faza aktuale e Programit duhet të synojë zhvillimin e marrëdhënieve me INSTAT-in për të mundësuar transferimin e menaxhimit të vëzhgimeve në modelin e tij standard të vëzhgimeve kombëtare.

#### Kapacitet i specializuar i policisë për prioritetet komunitare

Fokusi në zhvillimin dhe përmirësimin e zbatimit të një qasjeje të policimit në komunitet në PSS është përforcuar, duke siguruar që policia të ketë aftësitë e specializuara për të menaxhuar dhe për t'iu përgjigjur prioriteteve të komunitetit në momentin që ato identifikohen. Gjatë fazës së dytë, Programi u zgjerua nga fokusi i tij në dhunën në familje, me një element i fortë Programi që mbështet ndërgjegjësimin e të rinjve, për të adresuar një shqetësim të identifikuar të komunitetit në lidhje me policimin e qarkullimit rrugor. Këto tri fusha të gjinisë, qarkullimit rrugor dhe rinisë përfaqësojnë çështje kyçe të policisë që kanë nevojë për mbështetje nëse PSS-ja dëshiron të përmbushë pritshmëritë e komunitetit dhe të përmirësojë ofrimin e shërbimeve të saj.

| Reagimi policor ndaj prioriteteve komunitare              |                                                                           |                                            |
|-----------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|
| Reagimi policor ndaj dhunës në familje                    | Policimi efektiv i qarkullimit rrugor                                     | Përmirësimi i ndërgjegjësimin të të rinjve |
| - Trajnim për reaguesit e parë<br>- Zbatimi i monitorimit | - Ruajtja e kontrollit të shpejtësisë<br>- Zbatimi i sistemeve automatike | - Ndërgjegjësimi në shkolla                |



### **Përmirësimi i reagimit fillestar për të mbijetuarit e dhunës në familje**

Ndërsa reagimi i policisë ndaj të mbijetuarave është përmirësuar dukshëm, mbeten kufizime të dukshme në masën në të cilën kjo është një përgjigje e qëndrueshme. Çështja kryesore është se shumica e punonjësve në polici, të cilët janë të trajnuar mirë për reagimet e duhura, janë në kuadër të funksionit të policimit në komunitet dhe si të tillë nuk janë gjithmonë të parët që ndeshet me një viktimë që kërkon mbështetje. Trajnimi dhe angazhimi më i kufizuar me punonjësit e patrullës dhe atyre që bëjnë pritjen e parë në tavolinat e komisariateve mund të jenë shkak që reagimet fillestare ndaj ankesave të mos plotësojnë standardet e dëshirueshme dhe mund t'i dekurajojnë viktimat të angazhohen më tej me policinë. Riorganizimi i synuar i strukturës së policisë do t'i transferojë në poste të ndryshme oficerët e sensibilizuar rregullisht, dhe kjo mund të ndikojë në mundësinë që një viktimë të trajtohet siç duhet kur kontakton policinë.

Për t'iu përgjigjur kësaj çështjeje të identifikuar, Faza e Tretë e Programit duhet të kryejë trajnime të mëtejshme sensibilizuese për kërkesat ligjore dhe aftësitë praktike për gamën e oficerëve që vijnë në kontakt me viktimat. Realizimi i këtyre aftësive mund të përforcohet nëpërmjet një angazhimi më të gjerë monitorues, në nivelin e zonës ku struktura e re e policisë do të vendosë punonjësit që kanë kontaktin më të madh me komunitetin dhe që duhet të marrin ankesat më të drejtpërdrejta. Pjesa më e madhe e angazhimit monitorues mund të përafrohet dhe kryhet si pjesë e përpjekjeve për të siguruar që ristrukturimi të arrijë përmirësimet e synuara në zbatimin e policimit në komunitet.

Si trajnimi, ashtu edhe monitorimi duhet të kryhen në bashkëpunim me agjencitë e tjera përkatëse qeveritare, veçanërisht me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), nën të cilën janë punonjësit socialë të dhunës në familje dhe duhet të synojnë të përforcojnë zbatimin e mekanizmit kombëtar të referimit, që përfaqëson koordinimin reagues të përgjithshëm shtetëror.

### **Mbështetja për Drejtorinë e Qarkullimit Rrugor**

Ekipi i hartimit të Projektit vuri në dukje përdorimin e gjerë dhe të dobishëm të të dhënave nga drejtori dhe drejtuesit e lartë të Drejtorisë së Qarkullimit Rrugor. Përdorimi i të dhënave të qarkullimit rrugor dhe i lëvizjes së automjeteve

përdorej qartë për të orientuar angazhimin e patrullave të qarkullimit rrugor dhe teknologjinë e matjes së shpejtësisë. Shqetësimet kryesore në këtë fushë tani janë shkalla në të cilën PSS-ja është e aftë dhe e përgatitur për të ruajtur aftësinë aktuale.

Aksidentet fatale në qarkullimin rrugor janë reduktuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Shifra e regjistruar për vdekjet nga automjetet është 160 gjatë 12 muajve të fundit. Faza e mëparshme e Programit ishte e suksesshme në mbështetjen e zbatimit të një numri kamerash për kontrollin e shpejtësisë, që ka të ngjarë të kenë kontribuar në këtë përmirësim, së bashku me një sistem përpunimi automatik për gjobot. Ndërkohë që sistemi i plotë automatik nuk është zbatuar ende, për shkak të vonesave në miratimet në lidhje me menaxhimin e informacionit të IT-së, kamerat automatike tashmë kanë kontribuar në reduktimin e mundësive për sjellje të papërshtatshme të policisë me përmirësime të parashikuara konsekuente në perceptimet e reputacionit të policisë (këto ndërhyrje janë relativisht të reja dhe ndoshta ende shumë shpejt për të ndikuar në rezultatet e përgjithshme të studimit të perceptimit të policisë).

| Richard Bone        | Drejtues Ekipi, Programi i Zhvillimit i MB-së                        |
| Redion Qirjazi      | Menaxher Projekti, Reconnecting Albanian Youth & Society (RAYS)      |
| Edval Zolo          | Menaxher Projekti, Programi i Perspektivave të Reja                  |
| Jan Ake Kjellberg   | Policia Kombëtare Suedeze (në lidhje me video)                       |

### Qeveria e Shqipërisë

|                 |                                                                               |
|-----------------|-------------------------------------------------------------------------------|
| Romina Kuko     | Zëvendësministre, Ministria e Punëve të Brendshme                             |
| Daniela Cekani  | Drejtore, Projektet IPA & Lidhja e Donatorët, Ministria e Punëve të Brendshme |
| Elkana Himci    | Projektet IPA & Lidhja e Donatorët, Ministria e Punëve të Brendshme           |
| Etleva Sheshi   | Drejtore, Barazia Sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimeve Sociale    |
| Erinda Ballanca | Avokate e Popullit, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP)                 |
| Ahmet Prenci    | Komisar, Mekanizmi Kombëtar i Parandalimit, PAI                               |
| Shkelqim Allkaj | Drejtor, Drejtoria e Politikave, Ministria e Arsimit                          |
| Albana Çela     | Drejtore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Ministria e Arsimit                 |

### Policia e Shtetit Shqiptar - Drejtoria Qendrore

|                     |                                                     |
|---------------------|-----------------------------------------------------|
| Muhamet Rrumbullaku | Drejtor i Përgjithshëm                              |
| Redi Jaupi          | Drejtor i Lartë, Rendi dhe Siguria Publike          |
| Ferdinand Mara      | Drejtues i Parë, Drejtoria e Rendit Publik          |
| Altin Qato          | Drejtues i Parë, Drejtoria e Qarkullimit Rrugor     |
| Majlinda Vathi      | Specialiste, Sektori i Dhunës në familje            |
| Lindita Lushaku     | Specialiste, Sektori i Dhunës në familje            |
| Zenel Hyka          | Drejtor i Lartë, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse |
| Janaq Xhelili       | Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve Logjistike          |
| Zef Laska           | Drejtor i Lart, Shërbimet e Burimeve Njerëzore      |
| Besnik Baku         | Drejtor, Departamenti i Trajnimit                   |

### Policia e Shtetit shqiptar - Drejtoria e Tiranës

|                      |                                                                                 |
|----------------------|---------------------------------------------------------------------------------|
| Tonin Vocaj          | Drejtor, Drejtoria e Policisë së Tiranës                                        |
| Sejfulla Metko       | Drejtor Drejtorie, Drejtoria e Policisë së Tiranës                              |
| Luigi Vathi          | Drejtor Drejtorie, Policia e Rendit, Drejtoria e Policisë së Tiranës            |
| Idriz Dauliz         | Shef i Sektorit të Sigurisë Publike, Drejtoria e Policisë së Tiranës            |
| Nëpunës dhe Personel | Salla Operative, Drejtoria e Policisë së Tiranës                                |
| Nëpunës dhe Personel | Seksioni i Informacionit Kriminal dhe analizës, Drejtoria e Policisë së Tiranës |



Oliver Torba  
Faik Rugo  
Edison Visha  
Bajram Pasho

Komisar, Komisariati Kamzë  
Shefi i Policimit në Komunitet, Komisariati nr. 2, Tiranë  
Specialist i Policimit në Komunitet, Komisariati nr. 2, Tiranë  
Specialist i Policimit në Komunitet, Komisariati nr. 2, Tiranë

### Policia e Shtetit shqiptar - Drejtoria e Elbasanit

Ardian Cipa

Drejtör, Drejtoria e Policisë së Elbasanit  
Nëpunës dhe Personel Departamenti i Planifikimit dhe Analizës, Drejtoria e Policisë së Elbasanit

### Policia e Shtetit shqiptar - Drejtoria e Durrësit

Skender Hita  
Armır Gjikolla  
Dritan Allajbej  
Donald Krali

Drejtör, Drejtoria e Policisë së Durrësit  
Drejtör, Siguria dhe Rendi  
Shef i Seksionit Urban dhe Interurban  
Shef i Seksionit të Ankesave

### Policia e Shtetit shqiptar - Drejtoria e Beratit

Shkelqim Xhezairi  
Viron Nito

Zëvendësdrerjör, Drejtoria e Policisë së Beratit  
Shef i sektorit të Monitorimit dhe Analizës

### Akademia Shqiptare e Sigurisë

Ilirjan Mandro

Prof. dr., rektor/drejtör

### Këshilli Vendor për Sigurinë Publike, Elbasan

|                          |  |                                                                          |
|--------------------------|--|--------------------------------------------------------------------------|
| Elena Xhina              |  | Shefe e Kabinetit të Zyrës së Kryetarit të Bashkisë                      |
| Kreshnik Ajarj           |  | Kryeprokuror, Rrethi Elbasan                                             |
| Elvis Muco               |  | Koordinator, Shërbimet Shëndetësore dhe Sociale, Elbasan                 |
| Katerina Proco           |  | Sekretariati i KVSP-së, Elbasan                                          |
| <b>Bashkia e Beratit</b> |  |                                                                          |
| Eva Dhima                |  | Drejtör, Drejtoria për Integrimin në BE dhe Projektet                    |
| Pirro Xheblat            |  | Drejtör, Drejtoria e Shërbimeve Sociale                                  |
| <b>Akademia</b>          |  |                                                                          |
| Dorina Hoxha             |  | Profesor i Asociuar dhe Dekan, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tiranës |
| Aurela Anastasi          |  | Profesore, Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti Juridik,         |
| Universiteti i Tiranës   |  |                                                                          |
| Ervin Karamuco           |  | Profesor, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti Juridik,           |
| Universiteti i Tiranës   |  |                                                                          |
| Ivi Rrokaj               |  | Doktor, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti Juridik,             |
| Universiteti i Tiranës   |  |                                                                          |
| <b>OJQ &amp; OSC</b>     |  |                                                                          |
| Erinda Ndroqi            |  | Drejtore, Instituti për Aktivizëm & Ndryshim Social                      |
| Eldisa Lloshi            |  | Drejtore, Instituti për Ndryshim & Udhëheqje                             |
| Brikena Puka             |  | Drejtore, VATRA                                                          |
| Altin Hazizaj            |  | Drejtör, Qendra për të Drejtat e Fëmijës, Shqipëri                       |
| Sotirag Hroni            |  | Drejtör, Instituti për Demokraci & Ndërmjetësim                          |

### Ekipi i Menaxhimit të Projektit të FPKS-së

Ansi Shundi  
Arian Braha  
Jolanda Gugai

Drejtues Ekipi  
Punonjës Projekti  
Punonjëse Projekti



## ANEKSI D

Projektbuxheti në euro

| Artikulli                             | Hollësi / përlogaritje                                                                                                                       | Viti 1  | Viti 2  | Viti 3  | Viti 4  | Viti 5  | Totali           |
|---------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|---------|---------|---------|---------|------------------|
| Mbështetje për Policimin në Komunitet | Materiale trajnimi & ofrimi i trajnimit/mentorimit të vazhduar                                                                               | 50'000  | 50'000  | 50'000  | 50'000  | 50'000  | 250'000          |
|                                       | Monitorimi i përgjegjshmërisë dhe KVT                                                                                                        | 20'000  | 20,000  | 20,000  | 20,000  | 20,000  | 100'000          |
|                                       | Mbështetje për drejtimin e policisë                                                                                                          | 25'000  | 25'000  | 25'000  | 25'000  | 25'000  | 125'000          |
| Analizë dhe Përgjegjshmëri            | Mbështetje për KLSP-të                                                                                                                       | 40'000  | 40'000  | 40'000  | 40'000  | 30,000  | 190'000          |
|                                       | Mbështetje për Sektorët e Analizës dhe Monitorimit                                                                                           | 20'000  | 20'000  | 20'000  | 20'000  | 20,000  | 100'000          |
|                                       | Anketat në Komunitet                                                                                                                         | 30'000  | 30'000  | 30'000  | 30'000  | 30,000  | 150'000          |
| Aftësitë e Specializuara të Policisë  | Përmirësimi i ndihmës së parë për viktimat e dhunës në familje                                                                               | 25'000  | 25'000  | 25'000  | 25'000  | 25'000  | 125'000          |
|                                       | Policimi Efektiv i Qarkullimit Rrugor                                                                                                        | 25'000  | 25'000  | 25'000  | 25'000  | 25'000  | 125'000          |
|                                       | Ndërgjegjësimi i të Rinjve në shkolla                                                                                                        | 30'000  | 30'000  | 30'000  | 30'000  | 30'000  | 150'000          |
| Skema e Grandeve                      | Fondi i grandeve (deri në 10 000 euro)                                                                                                       | 120'000 | 120'000 | 120'000 | 120'000 | 120'000 | 600'000          |
|                                       | Menaxheri i Skemës së Grandeve                                                                                                               | 4'000   | 4'000   | 4'000   | 4'000   | 4'000   | 20'000           |
|                                       | Materiale publicistike, udhëtime, etj., dhe                                                                                                  | 50'000  | 50'000  | 50'000  | 50'000  | 50'000  | 250'000          |
| Menaxher Lokal i Programit            | Kohë e plotë gjatë kohëzgjatjes, duke përfshirë shpenzimet e udhëtimit                                                                       | 45'000  | 45'000  | 45'000  | 45'000  | 45'000  | 225'000          |
| Eksperti Ndërkombëtar i policisë      | Kohë e pjesëshme 50% - përfshin të gjitha dietat                                                                                             | 35'000  | 17'500  | 17'500  | 17'500  | 17'500  | 105'000          |
| Ekspert lokal M&E                     | Përfshin shpenzimet e udhëtimit; fitet e para me kohë të plotë, në vijim me kohë të pjesëshme                                                | 25' 000 | 25'000  | 25'000  | 25'000  | 25'000  | 125'000          |
| Personeli mbështetës (2)              | Përfshin bashkërendimin dhe administrimin                                                                                                    | 44'000  | 44'000  | 44'000  | 44'000  | 44'000  | 220'000          |
| Shpenzimet e zyrës                    | Përfshin qeranë, internetin, mirëmbajtjen e faqes së internetit, energjinë elektrike, ujin, telefonin, kancelaritë, printimin, pastrimin etj | 20'000  | 20'000  | 20'000  | 20'000  | 20,000  | 100'000          |
| Përkthimi                             |                                                                                                                                              | 5'000   | 5'000   | 5'000   | 5'000   | 5,000   | 25'000           |
| Inspektimet dhe auditimi i jashtëm    |                                                                                                                                              | 12'000  | 12'000  | 92'000  | 12'000  | 12'000  | 140'000          |
| <b>Totali</b>                         |                                                                                                                                              |         |         |         |         |         | <b>3'125'000</b> |

## VENDIM

Nr. 226, datë 17.4.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 926, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE, QË PRIVATIZOHET APO TRANSFORMOHET DHE PROCEDURËN E SHITJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Këtij vendimi i nënshtrohen të gjitha pronat e paluajtshme shtetërore dhe pasuritë e luajtshme, objektet e veçanta, mjetet kryesore dhe mjetet e xhiros të ndërmarrjeve shtetërore, të cilat plotësojnë kriteret për privatizim, sipas këtij vendimi.”.

b) Paragrafët i parë dhe i dytë të pikës 2 ndryshohen si më poshtë vijon:

“Institucionet qendrore dhe organet e njëjësive të vetëqeverisjes vendore dërgojnë kërkesat e tyre për privatizimin e pronave shtetërore që kanë në administrim ose në pronësi në ministrinë përgjegjëse për ekonominë. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr urdhrin për fillimin e procedurave të





privatizimit, sipas kërkesave të përmendura më sipër. Në rast se ministria përgjegjëse për ekonominë u kërkon institucioneve qendrore apo organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore kërkesën për prononcim privatizimi për pronat e paluajtshme shtetërore që kanë në administrim ose në pronësi, këto institucione janë të detyruara që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, të dërgojnë mendimin e tyre për privatizimin e këtyre pasurive.

Nëse institucionet qendrore apo organet e njësive të vetëqeverisjes vendore shprehen për mosprivatizimin e pronave shtetërore në administrim, apo në pronësi, apo pronave shtetërore të institucioneve që kanë në varësi administrative, atëherë ato duhet ta argumentojnë qartë këtë fakt.”

c) Në pikën 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Në paragrafin e parë, fjala “... kryetarin/kryetari ...” zëvendësohet me “... përfaqësuesin/përfaqësuesi ...”;

ii. Në paragrafin e dytë, fjalët “... ekspert kontabël ...” zëvendësohen me fjalën “... auditues ...”.

ç) Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Ekspertët vlerësues, në përbërje të komisionit të vlerësimit të pronës shtetërore përzgjidhen nga ministri përgjegjës për ekonominë. Pagesa e ekspertëve dhe çdo shpenzim për përgatitjen e dokumentacionit të vlerësimit përballen nga ministria përgjegjëse për ekonominë, përveç rasteve kur ministri përgjegjës për ekonominë urdhëron pagesën nga institucione, ndërmarrje dhe/ose shoqëri të varësisë. Kjo pagesë do të jetë 2 (dy) për qind e vlerës së objektit të vlerësuar, por jo më pak se 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe jo më shumë se 300 000 (treqind mijë) lekë, me TVSH.”.

2. Në kreun II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Me daljen e urdhrit të ministrit përgjegjës për ekonominë për ngritjen e komisionit të vlerësimit të pronës shtetërore që do të privatizohet, apo që do të përfshihet në fondin e kompensimit, komisioni i vlerësimit inspekton dhe verifikon gjendjen reale të pronës shtetërore dhe, më pas, ekspertët vlerësues të këtij komisioni, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, përgatitin në 5 (pesë) kopje origjinale genplanin e pronës shtetërore që do të privatizohet, ku përcaktohen qartë truallin nën objekt, truallin funksional dhe sipërfaqja e përgjithshme. Kur objekt privatizimi është truall, përcaktohet vetëm

sipërfaqja e truallit dhe eksperti vlerësues mban përgjegjësi për hartimin e saktë të këtij genplani. Dega e shoqërive publike përkatëse vendos një njoftim në mjediset e organit të qeverisjes vendore në territorin e të cilit ndodhet objekti, për efekt të ish-pronarëve të truallit, nëse ka.”.

b) Paragrafi i parë i pikës 4 shfuqizohet.

c) Në pikën 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Para fjalës “... ekspertët ...” shtohet “... eksperti/ ...”.

ii. Paragrafi i dytë numërohet pika 6.

ç) Fjala e parë e pikës 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Pas marrjes së genplanit të pronës shtetërore, të konfirmuar nga prefektura, dega e shoqërive publike i kërkon drejtorisë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, të dhëna për pronën shtetërore që privatizohet, kartelën dhe hartën kadastrale, certifikatën e pronësisë apo vërtetimin për pasuritë në një zonë kadastrale që nuk i është nënshtruar regjistrimit fillestar.”.

d) Në pikën 8 bëhen këto ndryshime:

i. Fjalët “... nga kjo agjenci, dhe ...” hiqen;

ii. Fjala e fundit shfuqizohet.

dh) Në pikën 9, fjala “... të objektit ...” hiqet.

e) Paragrafi i parë i pikës 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Në rastet kur ky çmim nuk ekziston në hartën e çmimeve, ekspertët vlerësues përcaktojnë çmimin e shitjes së pronës shtetërore që do të privatizohet. Eksperti vlerësues përcakton çmimin e shitjes së pronës shtetërore, në bazë të çmimit të përcaktuar në hartën e vlerës së pronave dhe të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur ky çmim nuk ekziston në hartën e çmimeve, ekspertët vlerësues përcaktojnë çmimin e shitjes së truallit të pronës që do të privatizohet sipas çmimit të tregut.”.

ë) Pika 11 ndryshohet si më poshtë vijon:

“11. Afati i plotësimit të dokumentacionit të vlerësimit për ndërtesat, ndërtimet dhe linjat e prodhimit/shërbimit, kur ato shiten së bashku me ndërtesën duhet të jetë jo më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e marrjes së urdhrit për ngritjen e komisionit të vlerësimit nga titullari. Për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit etj. ky afat duhet të jetë jo më shumë se 20 (njëzet) ditë, nga data e marrjes së urdhrit. Komisioni i vlerësimit mban përgjegjësi për respektimin e këtij afati.”.





f) Pika 12 ndryshohet si më poshtë vijon:

“12. Pas plotësimit të dokumentacionit, sipas afatit të parashikuar në pikën 11 të këtij kreu procedohet, si më poshtë vijon:

a) Komisioni i Vlerësimit, pasi përgatit dokumentacionin e plotë ligjor i dërgon drejtorisë përgjegjëse për privatizimin pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë me shkresë përcjellëse të nënshkruar e të vulosur nga dega e shoqërive publike përkatëse dokumentacionin për objektet ndërtimore dhe linjat e prodhimit/shërbimit, ku përcaktohen vlera e objektit, sipërfaqja e përgjithshme, ajo nën objekt dhe ajo funksionale;

b) Drejtoria përgjegjëse për privatizimin pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë, pasi kontrollon nëse dokumentacioni i marrë nga institucionet përkatëse është i plotë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore, ia përcjell atë Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës, së bashku me vlerësimin përmbajtësor, për verifikimin formal në kuadër të transparencës së procedurës së dokumentacionit të privatizimit të pronës shtetërore, që dërgohet për shitje.”

g) Pas pikës 12 shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

“12/1. Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, përfaqësues të strukturave përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për ekonominë. Komisioni drejtohet nga zëvendësministri. Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës i rekomandon ministrit përgjegjës për ekonominë vijimin e procedurës së privatizimit nga struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike, bazuar në vlerësimin përmbajtësor të drejtorisë përgjegjëse për privatizimin dhe nëse konfirmohet se dokumentacioni i kërkuar ligjor ka kaluar në të gjitha strukturat e parashikuara në këtë vendim. Në rast të kundërt, Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës kërkon plotësimin e dokumentacionit, duke e rikthyer dosjen në drejtorinë e përgjegjëse për privatizimin.”

gj) Në pikën 18, fjala “... (tunele) ...” hiqet.

3. Në kreun III bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Në paragrafin e tretë, të shkronjës “a”, fjalët “... komisioni i ngritur nga drejtori i strukturës për shitjen e pronës publike, në Ministrinë e Financave.”

zëvendësohen me “ ... struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.”

ii. Në shkronjën “b”, fjalët “... komisioni i ngritur nga drejtori i strukturës për shitjen e pronës publike, në Ministrinë e Financave ...” zëvendësohen me “... komisioni i ngritur nga struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për ekonominë ...”

iii. Në shkronjën “ç”, fjalët “... nuk është në gjendje të konfirmojë ...” zëvendësohen me “... nuk konfirmon ...”

b) Në pikën 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Në fjalinë e fundit, të shkronjës “a”, fjalët “... në një Buletin e Njoftimeve Zyrtare ...” zëvendësohen me “... në Buletin e Njoftimeve Zyrtare”

ii. Në shkronjën “c”, fjalët “... në prefekturë, ...” hiqen.

c) Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Pjesëmarrësit në ankand, pas regjistrimit të kërkesës në strukturën përgjegjëse për shitjen e pronës publike, në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, kanë të drejtë të njihen me dokumentacionin e vlerësimit, që ndodhet i depozituar në këtë strukturë, si dhe me gjendjen fizike të objektit.”

ç) Shkronja “b” e pikës 9 shfuqizohet.

d) Shkronja “b” e pikës 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) mandatpagesën apo garancinë bankare, që vërteton derdhjen ose ngurtësimin e 20 (njëzet) për qind të vlerës fillestare të ankandit në lekë, vetëm për objektin, për llogari të ministrisë përgjegjëse për ekonominë, detyrimisht, brenda afatit të pranimit të kërkesave;”

dh) Në pikën 17, fjalët “... të drejtorit të ...” hiqen.

e) Në shkronjën “a” të pikës 18, emërtimi “Ministria e Financave” hiqet.

ë) Në pikën 19 nënndarja “- përfaqësuesin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë.” zëvendësohet me “- përfaqësuesin e strukturës përgjegjëse për shitjen.”

f) Në fund të paragrafit të dytë të pikës 32 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në rast se nga informacioni zyrtar i marrë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës rezulton se objekti i kontratës së qirasë me tarifë 1 euro/kontrata nuk është në regjistrat kadastralë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse, nëse plotësohen rrethanat e



parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 34, të këtij kreu, trualli do të shitet nga struktura për shitjen e pronës publike dhe lidhja e kontratës bëhet sipas dispozitave të Kodit Civil, pasi të jetë bërë pagesa e plotë sipas vlerësimit të objekteve, bazuar dhe në vendimin e Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës.”.

g) Pika 33 ndryshohet si më poshtë vijon:

“33. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr urdhrin për përfshirjen në procedurë privatizimi të pronës shtetërore, objekt kontrate të dhënë me qira me tarifë 1 euro/kontrata, me sipërfaqe mbi 500 (pesëqind) m<sup>2</sup>, përpara përfundimit të kontratës së qirasë.”.

gj) Pas pikës 34 shtohen pikat 34/1, 34/2 dhe 34/3, me këtë përmbajtje:

“34/1. Në rastet kur prona shtetërore ka përmbushur rrethanat e pikës 34 të këtij kreu dhe në të ka dhe objekte ndërtimore shtetërore, procedura e shitjes së pronës bëhet sipas procedurave të parashikuara në kreun III të këtij vendimi.

34/2. Kur prona shtetërore ka përmbushur rrethanat e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 34 të këtij kreu dhe objekt i kontratës është vetëm trualli, subjektit i lind e drejta e privatizimit të drejtpërdrejtë, sipas procedurës së mëposhtme:

a) Drejtoria përgjegjëse për monitorimin e kontratave, pasi ka marrë miratimin e ministrit, në zbatim të akteve nënligjore në fuqi për fillimin e procedurave të privatizimit të drejtpërdrejtë, e përcjell dosjen të struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike për vijimin e procedurave;

b) Dosja duhet të përmbajë dokumentacionin, si më poshtë vijon:

i. Kontratat dhe anekset e kontratave të qirasë me tarifë 1 euro/kontrata, shoqëruar me dokumentacionin kadastral, geoplanin dhe procesverbalin e dorëzimit;

ii. Aktmonitorimet e qirasë;

iii. Urdhrin e ministrit përgjegjës për ekonominë për miratimin e vlerës së investimit dhe fillimin e procedurave të privatizimit të drejtpërdrejtë të pronës shtetërore, objekt i kontratës së qirasë.

34/3. Struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike i drejtohet Agjencisë së Trajtimit Pronave për të marrë konfirmimin nëse ka pronar me vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave dhe çmimin e truallit objekt privatizimi. Pas marrjes së konfirmimit nga ATP-ja, ministri përgjegjës për ekonominë emëron ekspertin vlerësues të pasurisë,

të licencuar, i cili harton genplanin e pronës, objekt kontrate me tarifë 1 euro/kontrata dhe përcakton vlerën e pronës. Eksperti vlerësues, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dalja e urdhrin të ministrit, përgatit në 5 (pesë) kopje origjinale genplanin përkatës, ku përcaktohen qartë sipërfaqja e përgjithshme dhe raporti i vlerësimit të pronës, objekt i kontratës së qirasë me tarifë 1 euro/kontrata, ku përcaktohet vlera e truallit që do të privatizohet, i cili përcaktohet, në bazë të çmimit të përcaktuar në hartën e çmimeve të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur ky çmim nuk ekziston në hartën e çmimeve, eksperti vlerësues përcakton çmimin e shitjes së pronës shtetërore të truallit që do të shitet, bazuar në vlerën e tregut. Eksperti vlerësues mban përgjegjësi për hartimin e saktë të këtij genplani dhe vlerën e pronës.”.

4. Në kreun III/1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Titulli ndryshohet si më poshtë vijon:

“Shkëmbimi i pronës shtetërore”.

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Kërkesa për kryerjen e shkëmbimit paraqitet nga institucionet qendrore dhe organet e njëjse të vetëqeverisjes vendore, ndërmarrjet shtetërore në varësi të tyre, të cilat kanë në përgjegjësi administrimi, pronësi ose përdorim pasurinë shtetërore, në vijim të quajtura bashkërisht “Organe propozuese”.”.

c) Në fund të shkronjës “ç” të pikës 8 shtohet fjalia, me përmbajtje:

“Në rastet kur prona që përfitohet nga shkëmbimi nuk plotëson kriteret e kërkuara nga organi propozues, por në të do të investohet deri në plotësimin e këtyre kriterëve sipas raportit të vlerësimit të investimit, atëherë organi propozues, me propozim të komisionit të vlerësimit të pasurisë, mund të nënshkruajë marrëveshje me kusht për realizimin e investimit. Shkëmbimi do të përfundojë sipas pikave 14, 15, 16 dhe 17, të kreut III, të këtij vendimi. Organi propozues regjistron këtë marrëveshje në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.”.

ç) Në shkronjën “a” të pikës 12 fjalët “... të dëshmojë aftësinë financiare ...” zëvendësohen me “... të vërtetojë se ka aftësi financiare ...”.

d) Shkronja “c” e pikës 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:



“c) raportet e vlerësimit të pronave që do të shkëmbehen, ku të jetë përcaktuar qartë plotësimi i të gjitha kriterëve të përcaktuara për pronën që ofrohet të shkëmbehet;”.

dh) Pas shkronjës “b” të pikës 18 shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) çdo shpenzim tjetër në zbatim të shkronjës “b”, të pikës 15, të këtij kreu.”.

5. Kudo në përmbajtje të vendimit, emërtimet “Ministria e Financave” dhe “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” zëvendësohen me fjalët “ministra përgjegjëse për ekonominë”, sipas kuptimit të fjalisë.

II. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia e Trajtimin të Pronës dhe çdo institucion tjetër, që preket nga dispozitat e tij, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**

**VENDIM**  
**Nr. 227, datë 17.4.2025**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË VENDIMIN NR. 600, DATË 9.10.2018,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
MIRATIMIN E SHËRBIMIT TË SIGURISË  
PUBLIKE NË INSTITUCIONET E  
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE TË  
KRITEREVE PËR OFICERËT E  
SIGURISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 81, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 600, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar, si më poshtë vijon:

a) institucionet e arsimit të mesëm të lartë gjimnaz, arsimit të mesëm profesional dhe arsimit të mesëm të orientuar, që kanë mbi 80 (tetëdhjetë) nxënës, të kenë 1 (një) oficer sigurie;

b) institucionet e arsimit bazë ose shkollat e bashkuara, që kanë mbi 350 (treqind e pesëdhjetë) nxënës, të kenë 1 (një) oficer sigurie;

c) institucionet e arsimit të mesëm të lartë gjimnaz, institucionet e arsimit të mesëm të orientuar, institucionet e arsimit bazë ose shkollat e bashkuara, që kanë mbi 900 (nëntëqind) nxënës, të kenë 2 (dy) oficerë sigurie;

ç) institucionet e arsimit të mesëm profesional, që kanë mbi 700 (shtatëqind) nxënës, të kenë 2 (dy) oficerë sigurie.

Institucionet e arsimit parauniversitar, që përfitojnë shërbim të sigurisë publike, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, përveç institucioneve të arsimit të mesëm profesional, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional. Shërbimi i sigurisë publike konsiston në monitorimin nga oficeri i sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar, të përcaktuara në këtë vendim, nëpërmjet ndërveprimit të vazhdueshëm të nxënësve, personelit mësimor dhe komunitetit.”.

2. Në pikën 2, pas fjalëve “... institucionet e sistemit arsimor parauniversitar, ...” shtohen “... të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, ...”.

3. Në fund të pikës 3 shtohen fjalët “... të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.”.

4. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit, konkurrimit dhe shpallja e rezultateve të konkurrimit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, përveç institucioneve të arsimit të mesëm profesional, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.”.

5. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Numri i oficerëve të sigurisë dhe shpenzimet përkatëse përballohen brenda numrit total të punonjësve dhe fondeve buxhetore, të miratuara për ministrinë përgjegjëse për arsimin. Për institucionet e arsimit të mesëm profesional, shpenzimet përkatëse përballohen brenda numrit total të punonjësve dhe fondeve buxhetore, të miratuara për



ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional.”.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Belinda Balluku

**VENDIM**  
Nr. 228, datë 17.4.2025

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 132, DATË 6.3.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË EKONOMISË SË MBETJEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 132, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”, bëhen këto shtesa:

1. Pas shkronjës “a”, të pikës 1, të kreut II, shtohet shkronja “a/1”, me këtë përmbajtje:

“a/1) të kryejë detyrat e autoritetit kontraktor për ministrinë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve për projektet/kontratat ekzistuese dhe të ardhshme të infrastrukturës së mbetjeve.”.

2. Pas shkronjës “c”, të pikës 7, të kreut III, shtohet shkronjat “c /1”, me këtë përmbajtje:

“c/1) shqyrton, autorizon e miraton, për ministrinë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve, në cilësinë e autoritetit kontraktor, procese që kanë të bëjnë me projektet/kontratat ekzistuese dhe të ardhshme të infrastrukturës së mbetjeve të lidhura sipas legjislacionit në fuqi për koncesionet e partneritetin publik dhe të atij të prokurimit publik, dhe mban korrespondencën e koordinon me të

kontraktuarit, institucionet dhe subjektet, të cilat janë palë në kontratat e lidhura.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Belinda Balluku

**VENDIM**  
Nr. 229, datë 17.4.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 710, DATË 12.10.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR KËRKESAT DHE KRITERET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË OPERATORIT TURISTIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 51, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin” të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr. 710, datë 12.10.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 të vendimit bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) emërtimi “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” zëvendësohet me “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”;

b) emërtimi “Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut” zëvendësohet me fjalët “Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit”.

2. Në shkronjën “dh”, të pikës 4, të nenit 2, të rregullores, që i bashkëlidhet këtij vendimi, fjalët “... pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, në përputhje me nenin 17, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, dhe rregulloren për trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave...” zëvendësohen me “... pranë strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit.”.

3. Neni 3 i rregullores ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 3

1. Operatori turistik përfaqësohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga përfaqësuesi ligjor (administra-



tori) dhe drejtuesi teknik, të cilët përveç kriterëve të përcaktuara në shkronjat “b” e “c”, të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) përfaqësuesi ligjor (administratori) dhe drejtuesi teknik të vërtetojnë se kanë pasur eksperiencë pune në veprimtari të tilla turistike, si: agjenci udhëtimi, strukturë akomoduese, operator turistik, operator turistik detar, udhërrëfyes turistik apo dhe në aktivitete të tjera të lidhura me turizmin;

b) drejtuesi teknik të jetë i punësuar vetëm në një operator turistik, në cilësinë e drejtuesit teknik;

c) drejtuesi teknik, për nevoja të ushtrimit të veprimtarisë së tij, të vërtetojë se zotëron të paktën një gjuhë të huaj nëpërmjet një dëshmie, certificate, diplome ose një dokumenti të ngjashëm me to, lëshuar nga subjekti i certifikuar nga ministria përgjegjëse për arsimin për organizimin e testeve ndërkombëtare, në nivelin B2, ose nga institucioni i arsimit të lartë publik apo privat, që është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, për të ofruar programe të akredituara të gjuhëve të huaja, me vlerësim mbi/edhe notën 7 (shtatë).

2. Përfaqësuesi ligjor dhe drejtuesi teknik, në çdo rast, janë përgjegjës për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje.”

II. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**

**VENDIM**  
**Nr. 230, datë 17.4.2025**

**PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE TË  
NEGOCIIMIT TË SHOQËRISË “KAYO”  
SHA, PËR SIGURIMIN E  
BASHKËPUNIMIT, ME QËLLIM  
NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR  
OFRIMIN E PROGRAMEVE TË  
EDUKIMIT DHE TRAJNIMIT TË  
PILOTËVE E TË KONTROLLORËVE  
TË FLUTURIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 4, të pikës 5, të nenit 5, të shkronjës “P”, të pikës 2, të nenit 7, dhe të pikës 3, të nenit 10,

të ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ky vendim ka për objekt miratimin e kushteve të negociimit të shoqërisë “KAYO” sh.a., me subjekte private për sigurimin e bashkëpunimit, me qëllim ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e programeve të edukimit dhe trajnimit të pilotëve të helikopterëve e të kontrollorëve të fluturimit.

2. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i kornizës së përgjithshme të kushteve të negociimit të shoqërisë shtetërore “KAYO” sh.a., me subjekte private për sigurimin e bashkëpunimit për ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e programeve të edukimit dhe trajnimit të pilotëve të helikopterëve e të kontrollorëve të fluturimit, në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes dhe të Strategjisë së Zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., negocion me shoqëri të specializuara, duke synuar krijimin e një bashkëpunimi për të ofruar programe edukimi dhe trajnimi për:

a) trajnimin e trajnerëve për programin e përgatitjes së pilotëve e të kontrollorëve të fluturimit;

b) trajnimin e pilotëve ushtarakë dhe civilë;

c) trajnimin e kontrollorëve të fluturimit, ushtarakë dhe civilë.

4. Shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., negocion me subjekte private për sigurimin e bashkëpunimit për ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e programeve të edukimit dhe trajnimit për:

a) pilotë të Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë;

b) pilotë të forcave ajrore të vendeve partnere;

c) pilotë civilë;

ç) kontrollorë të aviacionit civil të Republikës së Shqipërisë;

d) kontrollorë të aviacionit ushtarak të Republikës së Shqipërisë;

dh) kontrollorë të aviacionit ushtarak të vendeve partnere;

e) kontrollorë të aviacionit civil të vendeve partnere.



5. Shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., kryen negociata me subjekte private, vendase ose të huaja, të cilat përmbushin kriteret ligjore e teknike për ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e programeve të edukimit e të trajnimit të pilotëve të helikopterëve dhe kontrollorëve të fluturimit, sipas këtij vendimi.

6. Shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., në çdo rast dhe në çdo fazë të negociimit, bazohet në kërkesat teknike dhe operacionale, të paraqitura nga Ministria e Mbrojtjes, përmes strukturave të saj të specializuara dhe në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

7. Shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., ofron gjatë negociimit, si më poshtë vijon:

a) pasuri të paluajtshme të llojit ndërtesa, sipas projektit të përcaktuar në lejen e ndërtimit, të miratuar nga organet kompetente shtetërore, pa të drejtë tjetërsimi;

b) infrastrukturën e nevojshme të sigurisë dhe garantimin e sigurisë në të gjitha strukturat ku ofron trajnimin;

c) infrastrukturën mbështetëse logjistike për operimin e strukturave trajnuese, si: ujë, drita, shërbimin e internetit, sistemet e sigurisë dhe çdo sistem tjetër logjistik të nevojshëm për ngritjen e kapaciteteve, sipas standardeve të NATO-s;

ç) token për ndërtim;

d) përmbushjen e detyrimeve për të garantuar sigurinë fizike të personelit gjatë ofrimit të programeve të edukimit e të trajnimit, nëpërmjet kapaciteteve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

8. Shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., gjatë procesit të negociimit, në çdo rast dhe domosdoshmërisht, siguron nga subjekti me të cilin negocion minimalisht:

a) planet e detajuara të vendosjes së simulatorëve, së bashku me një përshkrim të nevojave për akomodimin e të gjitha pajisjeve të nevojshme për funksionimin e programeve;

b) simulatorët e fluturimit, duke garantuar përputhshmërinë me kërkesat e Forcave të Armatosura dhe standardet e NATO-s;

c) *software*-t e nevojshme për operimin e simulatorëve dhe të gjitha aparaturave të tjera;

ç) helikopterët mësimorë sipas numrit dhe llojit të përcaktuar në bashkëpunim me Forcën Ajrore të Republikës së Shqipërisë;

d) kurrikulat për trajnimin e pilotëve e të kontrollorëve të fluturimit;

dh) mirëmbajtjen e sistemeve dhe përditësimin e *software*-ve, sipas kushteve dhe për një periudhë të dakordësuar në marrëveshje mes palëve;

e) pjesët e këmbimit për helikopterët mësimorë, simulatorët dhe çdo pajisje tjetër të nevojshme;

ë) pajisjet, *software*-t, kurrikulat dhe çdo material, dokument apo informacion tjetër, që vihen në dispozicion, në përputhje me këtë vendim, nga subjekti që do të bashkëpunojë me shoqërinë “KAYO” sh.a., të cilat i kalojnë në pronësi shoqërisë shtetërore “KAYO” sh.a., sipas modaliteteve të dorëzimit dhe pagesave të përcaktuara në marrëveshjen mes palëve;

f) personelin trajnues të pajisur me shkollimin e duhur dhe lejet ose licencat e nevojshme që lejojnë punësimin e tyre si instruktorë/trajnues, në përputhje me standardet e NATO-s.

9. Shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., negocion çmimin e udhëhequr nga parimi i sigurimit të kushteve më të mira të kontratës, në përputhje me kërkesat operacionale dhe leverdisshmërisë ekonomike.

10. Shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., në çdo rast, mbetet pronar i objekteve që do të ndërtohen, në funksion të ofrimit të programeve të edukimit dhe trajnimit.

11. E drejta e menaxhimit e strukturës/strukturave të krijuara, me qëllim ofrimin e programeve të edukimit dhe trajnimit të pilotëve të helikopterëve e të kontrollorëve të fluturimit, nuk mund të ofrohet gjatë negociimit dhe mbetet, në çdo rast, e drejtë e shoqërisë shtetërore “KAYO” sh.a.

12. Shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., gjatë negociimit, nuk ofron në asnjë rast pjesëmarrje të subjektit që negocion në shpërndarjen e të ardhurave të krijuara nga ofrimi i programeve të edukimit dhe trajnimit të pilotëve të helikopterëve e të kontrollorëve të fluturimit.

13. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR  
Belinda Balluku

**URDHËR****Nr. 102, datë 8.4.2025****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe udhëzimin nr. 4, datë 29.1.2020, “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për nisjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogla apo direkte, si dhe nënshkrimin e kontratave për ushtrimin e aktiviteteve të AZHT-së te drejtori i Drejtorisë GIS, z. Endri Bala.

2. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1, të këtij urdhri, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhri deri më datë 31.9.2025.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, drejtori i Drejtorisë GIS, z. Endri Bala.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**  
**Adelajda Roka**

**URDHËR****Nr. 123, datë 15.4.2025****PËR DELEGIMIN E KRYERJES SË  
DETYRAVE QË KANË TË BËJNË ME  
PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 5, të nenit 21, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 26, dhe germës “i”, të nenit 37, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 73, të

vendimit të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të udhëzimit nr. 4, datë 18.6.2021, “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, si dhe të udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021, “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”;

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kancelarit, z. Donald Xhelili, për kryerjen e detyrave dhe nënshkrimin e akteve për të gjitha procedurat e prokurimit pranë kësaj gjykate.

2. Organi i deleguar nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

4. Ngarkohet kancelari, z. Donald Xhelili, për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ky urdhër hyn në fuqi në datë 15.4.2025 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYETAR**  
**Gerd Hoxha**

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë

